

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5971
E enjte, 9 janar 2020
çmimi 0.40 €

UP-ja dhe Komisioni i Pavarur i Mediave nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com


facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDERI I LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI, DHE AI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, ISA MUSTAFA, EDHE SOT (E ENJTE) DO T'I VAZHDOJNË NEGOCIATAT PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES PËR BASHKËQEVERISJE

LËVIZJE PËRAFRUESE

DREJT ARRITJES SË MARRËVESHJES LV - LDK



Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i janë afuar edhe më shumë arritjes së marrëveshjes për bashkëqeverisje në takimin e së mërkurës që kanë mbajtur liderët e këtyre dy subjekteve politike. Albin Kurti dhe Isa Mustafa nuk kanë folur pas takimit që ka zgjatur mbi tri orë, por zyrtarët e të dy subjekteve politike kanë konfirmuar se ka pasur përafime të qëndrimeve dhe lëvizje të reja drejt arritjes së marrëveshjes. "Epoka e re" nga burimet e veta ka mësuar se nëse LV-ja pajtohet që një ministri shtesë dhe postin e presidentit t'ia japë LDK-së, marrëveshja mund të nënshkruhet këtë të premte

IRANI KA SULMUAR BAZAT USHTARAKE AMERIKANE NË IRAK

Trumpi paralajmëron Iranin: ShBA-ja ka fuqinë ushtarake më të fortë në botë



Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka mbajtur të mërkurën konferencë për media pas sulmit të Iranit në bazat ushtarake amerikane në Irak. Ai ka thënë se për aq kohë sa ai është president i ShBA-së, Irani nuk do të ketë kurrë armë bërthamore. Trumpi ka pohuar se asnjë amerikan nuk është

plagosur nga sulmet e Iranit në dy baza ushtarake amerikane. Presidenti amerikan ka paralajmëruar Iranin se ShBA-ja ka fuqinë ushtarake më të fortë në botë. "Fakti që në kemi ushtri dhe pajisje të mrekullueshme, nuk nënkupton se ne duhet t'i përdorim", ka deklaruar Trumpi

OPINION

A MUND TË SHKOJË KOSOVA DREJT ZGJEDHJEVE TË REJA?

F. 11

Nga Bedri
ISLAMI



AKTUALE



KUNDËRSHTOHET ZHBËRJA E MINISTRISË SË KULTURËS

F. 5

KUVENDI MUND TA MIRATOJË BUXHETIN E VITIT 2020

F. 7

AMBASADORI ABBOTT: PËR BRITANINË E MADHE ARSIMI ËSHTË PRIORITET

F. 6



EKONOMI

BALAJ: TË PEZULLOHET VENDIMI PËR ULJEN E PAGAVE NË TELEKOM

F. 9

DOGANA E KOSOVËS KAP RRETH 100 000 FUNTA BRITANIKE NË AEROPORT

F. 8

SPORT

JOHNI RIKTHEHET NË KOSOVË ME SYNIME TË VJETRA

F. 20

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Tubim në Beograd kundër Ligjit për liritë fetare në Mal të Zi

BEOGRAD, 8 JANAR - Me thirrjet kundër udhëheqjes malazise dhe kundër pavarësisë së Kosovës, në Beograd u organizua të mërkurën një tubim i Kishës Ortodokse Serbe në mbështetje të siç thuhet, popullit të përvojatur serb në Mal të Zi, Kosovë dhe pjesë tjera të banuara me serbë.

Tubimi është pjesë e protestave kundër Ligjit për liritë fetare që u miratua më 27 dhjetor në Mal të Zi dhe hyri në fuqi të martën.

Ligji parashih hartimin e një regjistri të të gjitha objekteve fetare dhe zonave që dikur ishin

pronë e Mbretërisë së Pavarur të Malit të Zi, para se të bëhej pjesë e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, të dominuar nga serbët në vitin 1918, që më vonë u shndërrua në Jugosllavi.

Mbreti i atëhershëm Aleksandër Karaxhorxheviq, më 1919 kishte zhbërë Kishën malazeze dhe krejt pasuria e saj i kishte kaluar Kishës Ortodokse Serbe.

Drejtorja e pronave në Mal të Zi, sipas këtij ligji, deri më 8 janar të vitit 2021 duhet të hartojë listën e objekteve fetare.

Ligji u kërkon bashkësive fetare

që të ofrojnë dëshmi të qarta mbi pronësinë, dhe kjo kërkesë sipas Kishës Ortodokse Serbe, është hartuar për t'i marrë pronat e saj. Udhëheqësit e kësaj kisha u hodhën në protesta për ditë të tëra në Mal të Zi. Ata thonë se ligji i ri i mundëson Malit të Zi t'i konfiskojë pronat e kishës, duke përfshirë manastiret, kishat dhe pasuri të tjera. Këto pretendime janë mohuar vazhdimisht nga Qeveria malazise.

Presidenti pro-perëndimor i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, ka akuzuar Kishën Ortodokse



Serbe se po nxit politikat pro-serbe brenda vendit dhe po përpiqet të dëmtojë shtetësinë e tij.

Rama do ta vizitojë Rusinë, edhe ta takojë Putinin

Kryeministri shqiptar Edi Rama ka thënë të mërkurën, në konferencën me gazetarë në Vjenë, se shumë shpejt do të zhvillojë vizita në Rusi, ShBA dhe Ukrainë dhe takimet, qoftë edhe me Putinin, apo me liderë të tjerë, janë në kuadër të kryesimit të OSBE-së dhe angazhimeve që ai ka marrë



TIRANË, 8 JANAR - Shqipëria për herë të parë sot (e enjte) zyrtarisht do ta marrë kryesimin e OSBE-së për ta drejtuar atë gjatë vitit që sapo kemi hyrë. Kryeministri Edi Rama gjatë konferencës me gazetarë të mërkurën në Vjenë, e cilësoi këtë angazhim historik për Shqipërisë. "Kryesimi i OSBE-së nga Shqipëria është një arritje fantastike e Shqipërisë. Kjo organizatë është krijuar 45 vjet më parë dhe Shqipëria ka qenë jo vetëm vendi i vetëm evropian që e refuzoi, por edhe e goditi pa mëshirë që në krijim dhe sot ne jemi me gjithë këtë përgjegjësi për ta drejtuar OSBE-në", tha Rama. Natyrisht, tha ai, që nuk jemi të thirrur që të rishpikim OSBE-në apo t'i rishpikim mekanizmat e OSBE-së, por të çojmë përpara një përpjekje që nuk fillon me ne, nuk mbaron me ne, që bazohet mbi konsensusin në çdo hap, konsensusi i 57 vendeve, më shumë se mbi 1 miliard njerëzve, që kuptohet është një proces mjaft i komplikuar, sepse kupto-

het se duhet të bien dakord që të gjithë, ndërkohë që për vendet dhe zonat ku ka konflikte dhe çështje për të trajtuar, përgjithësisht janë edhe vetë anëtarë, kështu që edhe interesat divergjente janë pjesë. "Megjithatë, ne kemi bërë shumë punë për t'u përgatitur, edhe ministri në detyrë, edhe ambasadori kanë bërë një volum të madh pune dhe skuadra që është ngritur enkas për këtë mision special të një viti, ka përballuar një volum të madh pune, edhe do të bëjmë më të mirën tonë. Nuk pretendojmë të zgjidhim nyje që nuk janë zgjidhur me vite të tëra, por të ndihmojmë në progresin për zgjidhjen e tyre", deklaroi Rama.

Kryeministri tha se shumë shpejt do të zhvillojë vizita në Ukrainë, Rusi dhe ShBA si pjesë e detyrimeve të drejtuesit të OSBE-së.

Rama, tha se takimet, qoftë edhe me Putinin, apo liderë të tjerë janë në kuadër të kryesimit të OSBE-

së. Por, a do të ketë një diskutim me Putin për konfliktin më të fundit mes ShBA-së dhe Iranit pas vrasjes së gjeneralit të QUDS Kasem Sulejmani?!

Rama nuk pohoi asgjë në këtë drejtim, por të gjitha gjasat janë që të ketë një temë diskutimi edhe për këtë çështje, për aq kohë sa me Putin të do të ketë edhe një takim të kancelares gjermane Angela Merkel. "Vizita në Rusi është pjesë e agjendës së drejtuesit të OSBE-së dhe është pjesë e angazhimeve që unë kam marrë, ndërkohë që gjatë gjithë vitit kemi bërë dhe harmonizimin e angazhimeve me ministrin në detyrë për t'i balancuar obligimet e OSBE-së, me obligimet e brend-

shme. Janë disa vizita që do të bëhen shumë shpejt, praktikisht më të shpejtat janë vizitat në Ukrainë, në SHBA dhe Rusi. Për datat presim konfirmime nga të gjitha palët", tha Rama.

I pyetur se çfarë do të bëjë Shqipëria gjatë këtij viti për Kosovën, si kryesuese e OSBE-së, kryeministri Rama tha se "do t'i bëjmë të gjitha ato që kemi planifikuar dhe ju thashë nuk e marrim drejtimin e OSBE-së për të rishpikim OSBE-në, as për t'i rishpikim mekanizmat, qasjen tradicionale, sepse, faktikisht, vërtet jemi drejtues të organizatës për një vit, por është një drejtim që është shumëkoordinim me të tjerë dhe vendimmarrje që duhet

patjetër miratuar nga të tjerët. Pra, nuk është një drejtim i një qeverie në një vend. Në këtë aspekt, sigurisht që ne kemi disa ambicie. Kemi vendosur disa prioritetet. Kemi qenë të vëmendshëm që te vendosja e prioritetëve të mos vendosim prioritetet që janë dëshira, por të realizueshme dhe mendoj që e kemi kapacitetin e duhur që të bëjmë diçka dhe për Kosovën, aq më tepër tani që unë në Prishtinën zyrtare jam "tradhtar", në Beogradin zyrtar jam "nacionalisti më i rrezikshëm shqiptar". Kështu që, në këtë aspekt, besoj që kam një pozicion që mund të më shërbejë si chairman in office i OSBE-së", tha kryeministri Rama.

Kryesuesi i Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Shkup

Shkup, 8 janar - Kryesuesi i Komitetit Ushtarak të NATO-s, mareshali i aviacionit, Stjuart Piç, po qëndron për vizitë dyditore zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Piç, i cili është kryesues i trupit më të lartë këshillëdhënës të NATO-s,

të mërkurën ka realizuar takim me nikoqirin e tij, shefin e Shtatmadhorisë, gjeneralin Vasko Gjurçinovski dhe me ministren e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska me çka u informua mbi planet e procesit të transformimit të komandove

dhe njësiteve të Armatës. Gjatë qëndrimit në Shkup, Piç do ta vizitojë edhe Zyrën për lidhje të NATO-s, ndërsa sot (e enjte) do të pritët edhe nga presidenti i Republikës dhe komandanti suprem i Armatës, Stevo Pendarovski. (Alsat).



Irani ka sulmuar bazat ushtarake amerikane në Irak

Trumpi paralajmëron Iranin: ShBA-ja ka fuqinë ushtarake më të fortë në botë

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka mbajtur të mërkurën konferencë për media pas sulmit të Iranit në bazat ushtarake amerikane në Irak. Ai ka thënë se për aq kohë sa ai është president i ShBA-së, Irani nuk do të ketë kurrë armë bërthamore. Trumpi ka pohuar se asnjë amerikan nuk është plagosur nga sulmet e Iranit në dy baza ushtarake amerikane. Presidenti amerikan ka paralajmëruar Iranin se ShBA-ja ka fuqinë ushtarake më të fortë në botë. "Fakti që në kemi ushtri dhe pajisje të mrekullueshme, nuk nënkupton se na duhet t'i përdorim", ka deklaruar Trumpi

"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, në një konferencë për media mbajtur të mërkurën nga Shtëpia e Bardhë, ka thënë se për aq kohë sa ai është president i ShBA-së, Irani nuk do të ketë kurrë armë bërthamore. Ai ka thënë se asnjë amerikan nuk është plagosur nga sulmet e Iranit në dy baza ushtarake amerikane. "Të gjithë ushtarët tanë janë të sigurt dhe në bazën tonë ushtarake pati vetëm dëme minimale", ka thënë ai.

Trumpi ka deklaruar se do të vendosë sanksione më të fuqishme ekonomike ndaj Iranit, pas sulmit iranian me raketa kundër dy bazave ushtarake në Irak që strehojnë trupa amerikane.

Pas sulmit me raketa, presidenti Trump ka bërë me dije se Irani duket se është tërhequr. "Gjë që është diçka e mirë për të gjitha palët e interesuara dhe një gjë shumë e mirë për botën. Asnjë jetë amerikane ose irakiane nuk humbi për shkak të masave paraprake të shpërndarjes së forcave dhe të një sistemi paralajmërimi të hershëm që funksionoi shumë mirë", ka thënë ai. Vendet e botës, tha presidenti Trump, "e kanë toleruar gjatë sjelljen shkatërruese dhe destabilizuese të Iranit në Lindjen e Mesme dhe më gjerë, por ato ditë kanë marrë fund".

Trumpi ka thënë se Irani ka qenë sponsori kryesor i terrorizmit dhe synimi i tij për të pasur armë bërthamore kërcënon botën e civilizuar. "Sa kohë që unë të jam

president, Irani nuk do të lejohet të ketë armë bërthamore", është shprehur Trump.

Ai ka thënë se javën e kaluar ushtria e Shteteve të Bashkuara eliminoi terroristin më të madh në botë, Kasem Soleimani. Presidenti Trump ka thënë se Soleimani ishte personalisht përgjegjës për disa prej mizorive më të rënda. "Ai trajnoi ushtri terroriste, përfshirë Hezbollahun, nxiti luftëra të përgjakshme civile në të gjithë rajonin. Ai plagosi dhe vrau mijëra trupa amerikane. Duke eliminuar Soleimanin ne u kemi dërguar një mesazh të fuqishëm terroristëve", ka deklaruar Trump.

Ai ka theksuar se forcat e armatosura të ShBA-së janë më të forta se kurrë më parë. "Raketat tona janë po aq të fuqishme, vdekjeprurëse dhe të shpejta", ka thënë Trump, duke shtuar se pavarësisht se ShBA-ja ka ushtrinë dhe pajisjet më të fuqishme nuk do të thotë që duhet t'i përdorë ato. "Fakti që ne kemi ushtri dhe pajisje të mrekullueshme, nuk nënkupton se na duhet t'i përdorim. Ne nuk duam t'i përdorim ato. Fuqia amerikane, si ushtarake ashtu edhe ajo ekonomike, janë parandalueset më të mira", ka thënë ai.

Kosova dhe Shqipëria në përkrahje të ShBA-së

Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të kenë kujdes në udhëtimet drejt Irakut, Iranit dhe Jemenit, meqë konsiderohet se këto vende nuk ofrojnë siguri. Kjo ministri ka lëshuar një njoftim për media si



rezultat i tensioneve në rajonin e Lindjes së Mesme. Të martën Departamenti Amerikan i Mbrojtjes ka njoftuar se Irani ka sulmuar dy baza ushtarake amerikane në Irak. Televizioni shtetëror iranian ka njoftuar se ky sulm është hakmarrje ndaj vendimit të Shteteve të Bashkuara për ta vrarë komandantin e forcave elite iraniane, Qasem Soleimani, një javë më parë.

Përveç të tjerash, Ministria e Jashtme e Kosovës ka njoftuar se aktualisht ka aktivizuar misionet diplomatike në Arabi Saudite, Turqi, Katar dhe Emirate të Bashkuara Arabe për të ofruar mbështetje të nevojshme konsullore shtetasve të Kosovës në Irak dhe rajon.

Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë autoritetet janë duke bërë përpjekje për t'i identifikuar dhjetëra shtetas të Kosovës që punojnë në bazat amerikane Irak. "Ministria e Punëve të Jashtme është në kontakt të ngushtë me autoritetet për ta siguruar sigurinë e kosovarëve dhe në të gjitha kapacitetet tona ne do të ofrojmë ndihmën e nevojshme. Deri më tani të gjithë kosovarët janë të sigurt dhe shëndoshë e mirë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka dënuar sulmet e Iranit ndaj bazave ushtarake amerikane në Irak. Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se Kosova është në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA).

"Dënojmë hedhjen e raketave nga Irani në caqet e ShBA-së dhe koalicionit të fokusuar në luftën e mposhtjes së ISIS-it. Kosova është anëtare formale e këtij koalicioni dhe ne i bëjmë thirrje Iranit që të mos eskalojë në dhunë. Ne mbështesim ShBA-në dhe familjen euratlantike në këtë periudhë të turbullt", ka shkruar Thaçi.

Edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka dënuar sulmin e Iranit ndaj bazave ushtarake amerikane në Irak, duke vlerësuar këtë sulm si akt i rëndë agresioni ndaj ShBA-së.

Ai ka thënë Kosova qëndron e palëkundur në mbështetje dhe përkrahje të ShBA-së. "Njëkohësisht institucionet e Kosovës janë duke i përcjellë me vëmendje këto zhvillime që prekin edhe jetën e qytetarëve tanë, të cilët punojnë përkrah trupave amerikane në këto baza. Qeveria e vendit qëndron përkrah ShBA-së, në ofrimin e paqes dhe sigurisë në botë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kundër këtij sulmi ka reaguar edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli. "Dënoj sulmin e Iranit me raketa balistike ndaj bazave që strehojnë trupat amerikane në Irak duke e konsideruar një akt të rëndë agresioni ndaj ShBA-së, Irakut dhe paqes e stabilitetit ndërkombëtar. Shumë qytetarë tanë janë duke punuar në këto baza të aleatit tonë dhe prandaj ne ndihemi veçanërisht të shqetësuar për sigurinë e tyre. Institucionet e shtetit duhet ta kenë vëmendjen e plotë në situ-

atën në të cilën ndodhen ata. Kosova, si gjithmonë, qëndron përkrah ShBA-së, në luftën e saj kundër terrorizmit si dhe në misionin human për një botë të lirë, demokratike e paqësore", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka dënuar sulmin e Iranit ndaj bazave amerikane në Irak si dhe çdo sulm tjetër që ka për qëllim ta shkatërronë paqen kudo në botë. "Po ashtu, shprehim shqetësimin tonë për sigurinë e qytetarëve tanë të cilët punojnë në këto baza ushtarake të miqve tanë. Si gjithmonë, Kosova është rreshtuar krah ShBA-së dhe aleatëve të saj përëndimorë!", ka shkruar Limaj në rrjetet sociale.

Edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se raketat e lëshuara nga Irani drejt dy bazave ushtarake irakiane që strehojnë ushtarakë amerikanë dhe personel të koalicionit janë një veprim provokues me pasoja të rrezikshme për rajonin dhe stabilitetin e tij. "Irani duhet t'i respektojë marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet ndërkombëtare dhe detyrimet e tyre në interes të paqes. Shqipëria nuk është një vend djallëzor, por një vend demokratik që ka vuajtur nga një diktaturë djallëzore e pashembullt, ndaj të drejtat e njeriut i ka të shenjta. Prej dy dekadash Shqipëria mbetet e vendosur në angazhimet e saj përkrah ShBA-së dhe vendeve të NATO-s në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe çdo akti që vë në rrezik stabilitetin dhe paqen në botë", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".



LIDERI I LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI, DHE AI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, ISA MUSTAFA, EDHE SOT (E ENJTE) DO T'I VAZHDOJNË NEGOCIATAT PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES PËR BASHKËQEVERISJE

LËVIZJE PËRAFRUESE DREJT ARRITJES SË MARRËVESHJES LV - LDK

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i janë afruar edhe më shumë arritjes së marrëveshjes për bashkëqeverisje në takim të së mërkurës që kanë mbajtur liderët e këtyre dy subjekteve politike. Albin Kurti dhe Isa Mustafa nuk kanë folur pas takimit që zgjati mbi tri orë, por zyrtarët e të dy subjekteve politike kanë konfirmuar se ka pasur përafime të qëndrimeve dhe lëvizje të reja drejt arritjes së marrëveshjes. "Epoka e re" nga burimet e veta ka mësuar se nëse LV-ja pajtohet që një ministri shtesë dhe postin e presidentit t'ia japë LDK-së, marrëveshja mund të nënshkruhet këtë të premte

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 JANAR - Udhëheqësit e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të mërkurën kanë shënuar përparim në drejtim të arritjes së marrëveshjes për bashkëqeverisje. Ata nuk kanë treguar se cila nga këto parti ka bërë lëshime nga qëndrimet, por gazeta "Epoka e re" nga burimet e veta brenda dy partive ka mësuar se LDK-ja kërkon një ministri më tepër dhe postin e presidentit. "Palët janë në rrugë të mirë të arritjes së një marrëveshjeje për bashkëqeverisje. Meqenëse

kryeparlamentari, për të cilin ishin pajtuar t'i takojë LDK-së, tashmë e ka marrë LV-ja, LDK-ja kërkon një ministri shtesë. Po ashtu, LDK-ja kërkon që në marrëveshje të precizohet saktë se posti i presidentit i takon LDK-së", kanë thënë këto burime, duke shtuar se nëse arrihet pajtim në mes të palëve, marrëveshja mund të nënshkruhet këtë të premte. Pas takimit që ka zgjatuar më shumë se tri orë, zëdhënësi i LDK-së, Besian Mustafa, ka thënë se ka lëvizje të reja në drejtim të arritjes së marrëveshjes LV-LDK. "Takimi që ka filluar sot në orën 15:00 tanimë ka përfunduar. Kemi lëvizje në përp-

jekjen për të arritur marrëveshje në mes të dy palëve. Do të kemi një takim të radhës nesër, e për detaje ju informojmë nesër", ka thënë Mustafa. Edhe zyrtari i LV-së, Erzen Vraniqi, ka bërë me dije se në këtë takim ka pasur përafime të qëndrimeve në mes të subjekteve politike. Në profilin e tij në "Facebook", Vraniqi ka shkruar se takimi i radhës do të jetë drejt marrëveshjes. "Në kuadër të rifillimit të bisedimeve, në takimin e sotëm ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës pati përafime. Takimi i radhës drejt marrëveshjes për koalicionin qeverisës LVV-LDK është



nesër", ka shkruar Vraniqi. Ndërsa lideri i LV-së, Albin Kurti, para takimit me Isa Mustafën është shprehur më optimist se kurrë më parë për marrëveshjen. "Shpresoj se tash, pasi që kanë rifilluar bisedimet, edhe do të shkojmë me shpejtësi drejt arritjes së marrëveshjes, që edhe ashtu është shumë afër", ka deklaruar Kurti teksa ka shkruar në takim me liderin e LDK-së.

Analistët politikë, optimistë për marrëveshjen LV - LDK

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur optimizëm për arritjen e marrëveshjes për qeverinë e re në mes të LV-së dhe LDK-së. Ata kanë thënë se ka kohë të mjaftueshme që këto dy subjekte politike të arrijnë një marrëveshje. "Po që se dy partitë kanë vullnet për koalicion, ka kohë të mjaftueshme për ta arritur atë. Mbetet të shihen cilat do të jenë kërkesat e LDK-së dhe oferta e LV-së tash, pas situatës së krijuar me zgjedhjen e kryeparlamentarit", ka thënë për gazetën "Epoka e re" analisti politik Imer Mushkolaj. Edhe analisti tjetër politik, Artan Murati, beson se është e mundshme një marrëveshje në mes të këtyre partive. "Konsideroj se një marrëveshje në mes të LV-së dhe LDK-së është e mundshme dhe se ka

kohë të mjaftueshme për të ndodhur. Elementi më pozitiv në raport me të dyja subjektet është harmonizimi i programit qeverisës, pra puna e madhe për bashkëpunim potencial veçse ka përfunduar me sukses. Ndasitë mes të dy palëve janë kryekëput politike dhe nëse ka vullnet për ta shtyrë procesin përpara, e sidomos nëse reflektohet në vullnetin qytetar të 6 tetorit, sigurisht se mund të tejkalohen dallimet aktuale dhe mund t'i hapet rrugë një marrëveshjeje për bashkëqeverisje në mes të dyja palëve", ka thënë ai, duke shtuar se të dyja partitë duhet të jenë racionale në kërkesat e tyre për koalicion qeverisës. "Që të dyja subjektet duhet të jenë realiste në kërkesa. LV-ja nuk është fituese absolute e zgjedhjeve, e LDK-ja nuk i ka fituar ato. Pra, para se të ketë kërkesa maksimaliste nga të dyja palët, duhet të reflektohet në rezultatin real të zgjedhjeve. Kjo do ta lehtësonte arritjen e një marrëveshjeje të koalicionit", ka thënë Murati.

LV-ja do t'ia dërgojë presidentit me shkresë emrin e mandatarit

Lëvizja Vetëvendosje nuk ka përfillur kohën shtesë prej 48 orësh të presidentit Hashim Thaçi për dorëzimin e kandidatit për kryeministër. Pas mbledhjes së Kryesisë që ka mbajtur të mërkurën, LV-ja ka

treguar se mandatarin do t'ia dërgojë presidentit në ditët në vijim. "Sot u mbajt mbledhja e Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje. Në respektim të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenit 84, pika 14 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO 103/14, subjekti ynë do ta bëjë propozimin për mandatarin për kryeministër. Këtë propozim do t'ia dërgojmë me shkresë zyrtare presidentit të Republikës në ditët në vijim", është thënë në njoftimin për medie të LV-së.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të hënë, pas takimit të parë konsultativ me liderin e LV-së, Albin Kurti, i kishte dhënë afat prej 48 orësh LV-së për propozimin e mandatarit për kryeministër të vendit. Ky afat ka skaduar të mërkurën në orën 15:00. Në të kundërtën, presidenti kishte paralajmëruar se do t'i marrë veprimet e nevojshme kushtetuese. "Si president i vendit do ta ushtrij autoritetin tim kushtetues dhe ligjor të ruajtjes dhe kultivimit të unitetit politik e qytetar dhe orientimit euroatlantik të shtetit të Kosovës. Prandaj, kam vendosur që t'i ofroj z. Kurti kohë shtesë edhe 48 orët e ardhshme për nominimin e kandidatit/kandidates për kryeministër të ardhshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para se t'i marrë veprimet e radhës kushtetuese dhe ligjore", ka thënë Thaçi.

Kundërshtohet zhbërja e Ministrisë së Kulturës

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Rrjeti i Institucioneve të Pavarura të Artit dhe Kulturës nëpërmjet një komunikate përcjellë dhe shprehë shqetësimin e institucioneve anëtare, artistëve individualë dhe opinionit publik, në lidhje me planet për shpërbërjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), të bëra publike nga zyrtarët e partive politike që janë duke negociuar krijimin e Qeverisë së re të Kosovës. "Rrjeti i Institucioneve të Pavarura të Artit dhe Kulturës - RRIPAK kundërshton zhbërjen e MKRS-së dhe përsëritë kërkesën për krijimin e Ministrisë së Kulturës në Qeverinë e re të Republikës së Kosovës. Rrjeti i Institucioneve të Pavarura të Artit dhe Kulturës me këtë kumtesë përcjellë dhe shprehë shqetësimin e institucioneve anëtare, artistëve individualë dhe opinionit publik në lidhje me planet për shpërbërjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), të bëra publike nga zyrtarët e partive politike që janë duke negociuar krijimin e Qeverisë së re të Kosovës. RRIPAK kujton opinionin publik që me kumtesën e datës 2 dhjetor 2019 ka kërkuar krijimin e Ministrisë së Kulturës në Qeverinë e re të Republikës së Kosovës", është thënë në komunikatën e RRIPAK-ut.

Sipas kësaj komunikate, kjo kërkesë e institucioneve të organizuara në RRIPAK ka ardhur pas hulumtimeve dhe analizave të bëra nga Sekretariati i RRIPAK-ut duke pasur parasysh edhe zhvillimet në administrimin e këtij dikasteri qeveritar në periudhën e kaluar dhe mangësitë e trashëguara në qeverisje dhe programet zgjedhore të partive politike për artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore në Kosovë. RRIPAK thekson se partitë politike duhet ta rrisin urgjentsisht vëmendjen për rolin dhe

ndikimin shoqëror dhe zhvillimor të këtij aktiviteti të rëndësishëm shoqëror dhe ta fuqizojnë pozitën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore në qeverinë e re për të krijuar një paradigme të re zhvillimore në Kosovë duke trajtuar artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore si interes kombëtar dhe pikë parësore të politikave zhvillimore. "RRIPAK vlerëson të dëmshme për interesin publik dhe kombëtar të Kosovës planin për zhbërjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe mosthemelimin potencial të Ministrisë së Kulturës në Qeverinë e re të Republikës së Kosovës. RRIPAK planin për zhbërjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit e konsideron të rrezikshëm për kornizën ligjore të Kosovës, e cila administron institucionet publike dhe këtë sektor në Kosovë, të dëmshme dhe të rrezikshme për zhvillimin dhe funksionimin e institucioneve publike dhe të pavarura të artit dhe kulturës, të dëmshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe shkatërruese për punën artistike dhe kulturore në Kosovë në përgjithësi. RRIPAK ua tërheq vëmendjen zyrtarëve të partive politike që janë duke negociuar krijimin e qeverisë së re të Kosovës, që Ministria e Kulturës është pjesë e rëndësishme përbërëse e secilës qeveri progresive të vendeve të Evropës juglindore dhe vendeve të Bashkimit Evropian", është thënë në këtë komunikatë. RRIPAK ka theksuar se me zhbërjen eventuale të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe mosthemelimin e Ministrisë së Kulturës, Kosova do të veçohej nga shembujt e politikave progresive në vendet demokratike të Evropës juglindore dhe vendet e Bashkimit Evropian.



Aktakuzë kundër dy ish-pjesëtarëve të forcave policore serbe për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër dy personave me inicialet Z. K dhe D. Sh., për kryerje të veprave penale "krime të luftës kundër popullatës civile". Në një komunikatë për media, kjo Prokurori ka thënë se i pandehuri Z. K. ka shkelur rëndë rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare kundër personave civilë, si pjesëtarë i forcave policore serbe, gjatë kohës së luftës në Kosovë.

Sipas Prokurorisë, më 26 mars

të vitit 1999 i pandehuri në fjalë ka marrë pjesë në sulmin kundër 19 anëtarëve të nacionalitetit shqiptar në fshatin Nerodime e Epërme, të cilët nuk kanë qenë pjesë e konfliktit të armatosur. "Gjatë këtij aksioni, i pandehuri, përveç të tjerash, ka marrë pjesë në maltretimin e anëtarëve të kësaj familjeje, shkatërrimin e pasurisë së tyre, dëbimin nga vendbanimi i tyre, rrëmbimin dhe vrasjen e civilëve O. N., B. N., A. N dhe B. N., anëtarë të kësaj familjeje", është thënë në

komunikatë.

Ndërkaq i pandehuri D. Sh. akuzohet se më 1 prill të vitit 1999 ka urdhëruar që të varrosen trupat e pajetë të O. N., B. N., A. N., B. N dhe I. R., të vrarë nga forcat policore dhe paramilitare serbe, teksa ka vepruar në cilësinë e inspektorit policor.

Prokuroria ka thënë se trupat e personave të përmendur janë varrosur "pa dinjitet dhe në kundërshtim me rregullat e luftës të përcaktuara me të drejtën humanitare ndërkombëtare".



UP-ja dhe Komisioni Pavarur i Mediave nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 JANAR - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kanë nënshkruar të mërkurën një memorandum bashkëpunimi.

Rektori i UP-së, Marjan Dema, ka thënë se ata që do të përfitojnë më së shumti nga ky bashkëpunim janë studentët e gazetarisë të cilët do të kenë mundësi të njihen më mirë me funksionimin e mediave elektronike në vend. "Është kënaqësi që jemi takuar së

bashku pas këtyre festave dhe ky fillimviti fillon me një punë të mbarë. UP-ja është në vazhdim të fuqishme të bashkëpunimeve në mënyrë që t'i avancojë më shumë shkathësitë e studentëve sepse ato nuk janë të mjaftueshme vetëm gjatë studimeve. Me këtë marrëveshje

sigurisht se do të përfitojnë studentët e gazetarisë, pasi gazetaria është një shtyllë me rëndësi. Sa më shumë gazetarë profesionalë që do të japim do të përfitojmë nga zhvillimi ekonomik dhe demokracia. Në këtë marrëveshje janë paraparë modalitetet e bashkëpunimit në të gjitha fushat dhe shpresojmë të kemi suksese që t'i realizojmë të gjitha këto pika", ka thënë rektori demaj.

Kryetari i Komisionit të Pavarur të Mediave, Muja Ferati, ka thënë se ky bashkëpunim ka

ardhur si nevojë për ta parë nga afër funksionimin e mediave elektronike në Kosovë. Ai ka theksuar se nga ky bashkëpunim do të mund të përfitojë edhe stafi akademik i UP-së. "Ky është rast ku studentët mund të njihen me strukturat ligjore të KPM-së. Ne kemi menduar që këtë ta shfrytëzojë edhe stafi akademik tjetër, si komponent do të mbahen ligjëratat jashtë orarit të rregullt. Si komponent tjetër është edhe edukimi medial", ka thënë Ferati.

ShSKUK-ja: Dy kardiokirurgët lanë punën në QKUK për angazhim në spital privat

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - "Ashtu siç kishte deklaruar dhe paralajmëruar më parë Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, arsyet e vërteta pse dy mjekët specialistë kardiokirurgë lëshuan punën në QKUK, është për shkak të angazhimit të tyre në një spital privat, e që tashmë është vërtetuar nga ky spital", është bërë me dije në njoftimin e ShSKUK-së.

Sipas ShSKUK-së, për qëllime biznesore dhe personale u veprua për ta dëmtuar imazhin e ndërtuar me punë dhe mund nga QKUK-ja për Klinikën e Kardiokirurgjisë. "Janë të çuditshme deklaratimet e pamatura të disa deputetëve dhe politikanëve që dolën me deklaratatë të pavërtetuara dhe paverifikuara paraprakisht për situatën reale. ShSKUK-ja ka



njoftuar se i ka përkrahur dhe i përkrah mjekët që aftësitë profesionale t'i aplikojnë në praktikë, por nuk do të lejojë që të dëmtohet imazhi i

institucionit për përfitime të individëve të caktuara, që në plan të parë kanë përfitimet personale", është bërë me dije në njoftimin e ShSKUK-së.



Ambasadori Abbott: Për Britaninë e Madhe arsimit është prioritet

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, me të cilin ka biseduar për gjendjen e arsimit në Kosovë dhe bashkëpunimin mes dy vendeve në të gjitha nivelet e arsimit.

Ministri Bytyqi e ka falënderuar ambasadorin Abbott për ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë Britania e Madhe

për Kosovën, veçanërisht në fushën e arsimit, ku me projekte të mëdha i ka dhënë ndihmë të madhe sistemit arsimor. Ndërsa ambasadori Abbott theksoi se për Britaninë e Madhe arsimit është prioritet, pra edhe bashkëpunimi në këtë sektor është shumë i rëndësishëm, sidomos kur merret parasysh fakti se Britania e Madhe ka sistem të zhvilluar të arsimit dhe ka mundësi të japë kontribut për zhvillimin e arsimit në Kosovë.

Kuvendi mund ta miratojë buxhetin e vitit 2020

Vitin 2020 Kosova e ka nisur pa buxhet të miratuar. Ndonëse për tre muajt e parë të këtij viti nuk pritet që të ketë problem, në rast të mosmiratimit të buxhetit deri në muajin prill rrethanat mund të ndryshojnë

PRISHTINË, 8 JANAR - Nëse nuk kalon buxheti për këtë vit, nga muaji prill ndalen të gjitha pagesat për paga, për pensione e për shërbime të tjera. Ministria e Financave ka përgatitur projektbuxhetin për vitin 2020 me kohë, por në mungesë

të konstituimit të Kuvendit nuk ka qenë i mundur dërgimi në Kuvend të Kosovës. "Nëse subjektet politike merren vesh, projektligji për buxhet mund të dërgohet në Kuvend nga qeveria në dorëheqje dhe i njëjti të miratohet", ka thënë për RTK

këshilltari i ish-ministrit të Financave Bedri Hamza, Lulzim Rafuna.

Safet Gërxhaliu, ekspert i ekonomisë, thotë se në këtë situatë sektori privat do të pësojë më së shumti nga mungesa e miratimit të buxhetit të Kosovës dhe se bankat në Kosovë do të jenë përfituese në këtë situatë, sepse bizneset do të duhet të hyjnë në kredi të shumta për të operuar pasi, siç dihet, sektori privat është shtyllë kryesore e ekonomisë së Kosovës. "Nëse nuk miratohet buxheti i vitit

2020, ai që do të pësojë më së shumti është sektori privat, pasi bizneset do të jenë të detyruara të hyjnë në kredi për t'i përbushur nevojat e tyre", ka thënë Gërxhaliu.

Sipas tij, është urgjencë që sa më shpejt të miratohet buxheti. "Nëse nuk miratohet buxheti, do të ketë mungesë të realizimit të investimeve kapitale, po ashtu edhe do të ketë probleme të bizneseve vendore. Sektori privat do të jetë i goditur. Me qeverinë e re do të duhet të ketë projeksione të tjera, pasi koalicioni i ri, nëse

krijohet, do të ketë prioritete të tjera", ka thënë ai.

Gërxhaliu ka theksuar se nëse nuk miratohet buxheti duhet të gjendet zgjidhje tjetër, duke përfshirë edhe që të kyçet presidenti.

Kosova ka miratuar vetëm korniza afatmesme të shpenzimeve 2020-2023, e cila paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të duhej të hartohej buxheti vjetor për vitin 2020. Sipas kësaj kornize, buxheti i Kosovës parashihet të jetë rreth 2.4 miliardë euro.



Kosova në vendin e 99 për nga fuqia e pasaportës

PRISHTINË, 8 JANAR - Kosova është në vendin e 99 në botë për nga fuqia e pasaportës, pasi qytetarët e saj mund të udhëtojnë pa viza në vetëm 40 vende. Ky është rezultati i një hulumtimi të kompanisë "Henley Passport Index", që flet për fuqinë e pasaportave të shteteve të botës, bazuar në lirinë e lëvizjes së bartësit të një pasaporte në shtete të ndryshme, pa pasur nevojë për

vizë'.

Pas Kosovës, renditen Sudani, Koreja e Veriut, Nepali, Libia etj. Nga vendet e rajonit, Serbia është në vendin e 39, qytetarët e së cilës mund të udhëtojnë pa viza në 133 vende, Mali i Zi në vendin e 46, Maqedonia e Veriut në vendin 47, qytetarët e së cilës mund të lëvizin pa viza në 123 vende, Bosnje dhe Hercegovina renditet 52-ta me 117 vende, dhe Shqipëria në pozitën e 54-t.

Në vendin e 107 dhe të fundit në listë renditet Afganistani. Qytetarët e këtij vendi mund të udhëtojnë pa viza në vetëm në 26 vende.

Pasaportat më të fuqishme në botë, sipas kësaj organizate, janë të Japonisë dhe Singaporit. Rezultatet e këtij hulumtimi janë bazuar në të dhënat ekskluzive nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror.



Gjermanët, pavarësisht prej sfidave, optimistë për ekonominë e tyre

Ekspertët presin një rritje më të madhe ekonomike të Gjermanisë në vitin 2020, por rreziku i recesionit për ekonominë më të madhe të BE-së nuk është eliminuar

BERLIN, 8 JANAR - Parashikimi se Gjermania do të ketë rritje më të mirë ekonomike këtë vit bazohet kryesisht në faktorë të jashtëm botërorë, pasi dihet që ekonomia gjermane është shumë e varur nga sukcesi i eksporteve të mallrave gjermane. Dhe problemet aktuale që ka ekonomia gjermane nuk janë të tilla sa të përjashtojnë një zhvillim më të fuqishëm të ekonomisë, edhe 14 vjet pas rritjes së vazhdueshme të prodhimit ekonomik në Gjermani. Ishte ministri i Ekonomisë i Gjermanisë, Peter Altmaier, ai që deklaroi në ditët e fundit të vitit 2019, se "qartësia më e madhe për Brexitin" do të ndikojë pozitivisht për ekonominë gjermane. Në Gjermani kanë besim, se qeveria e Boris Johnsonit, me shumicën e fortë që ka në parlament, do t'i japë fund periudhës së pritjes pezull për të gjithë, pra edhe për sipërmarrësit gjermanë. Një faktor i dytë shpresëdhënës lidhet me deklaratën e Vitit të Ri se ShBA-ja dhe Kina do të nënshkruajnë në mes të janarit një marrëveshje tregtare. Kjo shpresohet se do të ndikojë në shtensionimin e marrëdhënieve tregtare botërore, edhe të Kinës me shtetet e tjera. Tarifat e vendosura doganore, në plan afatmesëm, e godasin kudo mirëqenien.

Sfidat kryesore të ekonomisë gjermane

Njëkohësisht, sfidat për ekonominë gjermane mbeten të njëjta. Katër sfida vështrohen

aktualisht si kryesore për ekonominë gjermane: së pari, digjitalizimi i procesit të prodhimit. Këtu Gjermania ecën ngadalë deri tani. Shkaku ka qenë kryesisht skepticizmi të sipërmarrjet e mesme. Së dyti është kalimi tek automjetet elektrike. Sfidat e tretë është deglobalizimi. Ka humbur shumë besim në proceset ndërkombëtare. Dhe kjo ndihet edhe në Gjermani. Ka një rënie të dukshme të besimit të fuqia detyruese e kontratave ndërkombëtare. Një ekonomiste e "Deutsche Bank" tha se sipërmarrjet mund të mbështeten tani më pak në zinxhirët e furnizimit ndërkombëtar sesa vitet e kaluara. Kjo mund të bëjë që vendet e punës të krijuara jashtë të tërhiqen më fort në Gjermani e Evropë.

Sfida e katërt është reduktimi i emisioneve të dyoksidit të karbonit. Kjo nuk është sfidë vetëm për automjetet gjermane, por për gjithë ekonominë. Vitin e kaluar Gjermania pati rritjen më të ulët ekonomike në Eurozonë. Me 0,5 për qind mendohet se u rrit prodhimi ekonomik i Gjermanisë në 2019-n. Kjo ndonëse në fillim të vitit pritej një rritje prej 1,8 përqindësh. Vetëm Italia e zhytur në borxhe pati rritje më të dobët ekonomike se Gjermania. Sipas "Frankfurter Allgemeine Zeitung", lokomotiva gjermane e rritjes u rreshtua kështu brenda një kohe të shkurtër në fund të autokolonës së kombeve të mëdha të industrializuara. Me përjashtim të viteve të krizës 2012-2013, kjo ishte rritja më e



ulët ekonomike prej recesionit të gjerë të vitit 2009.

Në Gjermani u krijua dyfishi i vendeve të punës të Eurozonës

Në tregun e punës gjendja vazhdon të jetë e mirë. Kur lexon shifrat që publikohen këto ditë e kupton edhe më mirë burimin e raportimeve mediatike thujse vetëm pozitive për zhvillimin e Gjermanisë; ato janë shpjegim edhe se pse Gjermania vazhdon të dallohet si magnet për shumë të huaj, që duan të vijnë të punojnë në Gjermani. Sipas të dhënave të "Frankfurter Allgemeine Zeitung", nga viti 2007 deri vjet në Gjermani janë krijuar mbi pesë milionë vende të reja pune. Ky është dyfishi i vendeve të reja të punës që janë krijuar në të gjitha vendet e Eurozonës së bashku.

Kurse numri i të papunëve për një kohë të gjatë në fund të vitit 2019 ra për herë të parë në 700 000 veta. Përballë 45,6 milionë të punësuarve me sigurime

sociale vitin e kaluar. Me gjithë lajmet negative në 2019-n për perspektivat e ekonomisë gjermane, edhe sipërmarrjet e mëdha gjermane vazhdojnë të punësojnë me ritme të larta. Por nga ana tjetër është dyfishuar edhe numri i pushimeve nga puna, krahasuar me një vit më parë. Vjet ai arriti në 93 000 veta.

Digjitalizimi dhe automatizimi, shkak për pushimet nga puna?

Si shkaqe për pushimet nga puna në sipërmarrje shpesh citohen digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës, që po avancojnë edhe në Gjermani. Por ekspertë të ndryshëm thonë se digjitalizimi i procesit të punës për momentin e ka shtuar punën, pasi edhe transformimi bëhet nga njerëzit. Pushimet nga puna, sipas tyre, kanë të bëjnë kryesisht me dy shkaqe: së pari me transformimin në industrinë automobilistike, me kalimin nga motori me djegie të brendshme

në motorin elektrik. Ky proces është në fillim edhe në Gjermani. Por dihet që për motorin elektrik nevojiten më pak hapa pune se për motorin me djegie të brendshme. Kështu që pushime nga puna kanë bërë ndërtues të mëdhenj automjetesh si Audi, Volkswageni, Opel, Fordi. Por veç tyre edhe firma furnizuese si Continental, Bosch-i, Schaeffler etj. Shkaku i dytë për pushimet nga puna në Gjermani janë konfliktet tregtare në botë, si ai mes Kinës dhe ShBA-së dhe Brexiti.

Ndërsa në sektorin e shërbimeve në Gjermani, gjendja është e mirë dhe, sipas ekspertëve, pritet të përmirësohet edhe më tej. Në këtë sektor në Gjermani nevojiten që nga personeli sanitar e ai përkujdesës deri te mësuesit. Por shërbimet pritet të shtohen edhe në sektorin e transportit, p. sh., për mirëmbajtjen e skuterëve elektrikë, që i sheh prej disa muajsh edhe në rrugët e Gjermanisë. Industria e ndërtimeve, artizanati dhe konsumi privat vazhdojnë gjendjen e nisur shumë të mirë. (DW)

Dogana e Kosovës kap rreth 100 000 funta britanike në aeroport

PRISHTINE 8 JANAR - (ER) Oficerët doganorë kanë arritur ta parandalojnë futjen ilegale të sasisë prej 100 000 mijë funtave angleze në pikëkalimin ndërkombëtar të aeroportit. Lajmin e ka bërë me dije të mërkurën përmes një njoftimi për media Dogana e Kosovës. "Dje në orët e pasdite një udhëtar anglez ka hyrë në kanalin e gjelbër ku edhe është

selektuar nga oficerët doganorë për kontroll pasi imazhet në skaner kanë shfaqur parregullsi potenciale. Kontrolli fizik i udhëtares ka gjetur mjete monetare të fshehura në thellësi të çantës të vakumuara. Pasi janë gjetur udhëtarja është kontrolluar detalisht si dhe është vendosur nën kontroll", është bërë me dije në njoftimin për media të Doganës. Mjetet monetare

janë ndaluar si dhe rasti ka vazhduar për hetime të mëtejme, përmes Sektorit të Hetimeve në Doganën e Kosovës. "Dogana u bënë ftesë të gjithë qytetarëve që udhëtojnë, se kanë obligim ligjor ta bëjnë deklarinimin e mjeteve monetare të cilat i bartin me vete në vlerë mbi 10 000 mijë euro", është theksuar në këtë njoftim.



Balaj: Të pezullohet vendimi për uljen e pagave në Telekom



Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit, Lamih Balaj, është takuar sot me bordin e kësaj ndërmarrje dhe ka kërkuar që të pezullohet vendimi për uljen e pagave në Telekomin e Kosovës, së paku deri në fund të marsit

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 JANAR - Javën që lamë pas, gjegjësisht më 03. 01. 2020, të gjithë punëtorëve të Telekomit të Kosovës u është dërguar një e-mail, me anë të të cilit janë njoftuar për zvogëlimin e pagave. Referuar gjendjes së rëndë financiare në të cilën ndodhet Telekom i Kosovës, në këtë e-

mail është bërë me dije se punëtorët e kësaj kompanie nga 1 janari pritet të kenë paga më të vogla për 10 dhe 20 %.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit, Lamih Balaj, është takuar sot me bordin e kësaj ndërmarrje dhe ka kërkuar që të pezullohet vendimi për uljen e pagave në Telekomin e Kosovës, së paku deri në fund të marsit. "Sigurisht

se kërkesa jonë është e qartë për pezullim të vendimit deri në vendimin e Gjykatës Kushtetues për paga. FSP-PTK-ja ka qenë dhe do të jetë e përkushtuar që Telekom i Kosovës të ecë hapave të sigurt dhe drejt rimëkëmbjes. Takimi ka qenë, po e them maratonik, me diskutime dhe pajtime të dyanshme në favor të Telekomit", ka thënë Balaj për gazetën "Epoka e re".

Diskutohet për uljen e numrit të automjeteve të paregjistruara

PRISHTINË, 8 JANAR - Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku dhe shefi i Zyrës Ligjore, Venhar Hana, kanë takuar nënkolonelin e Policisë së Kosovës, Jeton Rexhepi, si dhe stafin mbështetës të Divizionit të Komunikacionit Rrugor pranë Policisë së Kosovës. Përmes një postimi në profilin e vet në "Facebook", Mazreku ka njoftuar se në këtë takim palët kanë diskutuar në lidhje me vazhdimin e bashkëpunimit dhe organizimin e kampanjave të përbashkëta lidhur me: uljen e numrit të mjeteve motorike të paregjistruara/pasiguruara në qarkullim rrugor, shpërndarjen e broshurave të ndryshme lidhur me rritjen e vetëdijesimit e qytetarëve për zvogëlimin e aksidenteve në trafik, si dhe iniciativat për ndryshimin e

Ligjit për Automjete. "Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku dhe shefi i Zyrës Ligjore, Venhar Hana, kanë takuar nënkolonelin e Policisë së Kosovës, Jeton Rexhepi, si dhe stafin mbështetës të Divizionit të Komunikacionit Rrugor pranë Policisë së Kosovës. Në takim palët kanë diskutuar lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit dhe organizimin e kampanjave të përbashkëta lidhur me: uljen e numrit të mjeteve motorike të paregjistruara/pasiguruara në qarkullim rrugor, shpërndarjen e broshurave të ndryshme lidhur me rritjen e vetëdijesimit e qytetarëve për zvogëlimin e aksidenteve në trafik, si dhe iniciativat për ndryshimin e Ligjit për Automjete", ka shkruar Mazreku, duke shtuar se palët janë pajtuar për



organizimin e ngjarjeve si më sipër në çdo kuartal, ndërsa

për çështje të tjera të rëndësishme të njëjtë do të ketë edhe

takime dhe diskutime edhe në ditët në vijim.

Komuna e Prizrenit të premten mban debat publik për çështjen e kulturës

PRIZREN, 8 JANAR (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nesër (e premte) do të organizojë debat publik për

hartimin e rregullores për subvencionim nga fusha e kulturës. "Në këtë debat ftohen të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve nga Komuna e

Prizrenit që veprojnë në fushën e kulturës, për ta dhënë kontributin e tyre për hartimin e kësaj rregulloreje. Debatu publik mbahet më 10.

01. 2020 (e premte) në orën 14:00, në Sallën e Kuqe (kati i tretë) të objektit të administratës komunale", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Mbahet manifestimi 'Shala heroike'

MITROVICË, 8 JANAR (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, është mbajtur manifestimi "Shala heroike" në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica" në këtë komunë. Në këtë manifestim ishin të pranishëm kryetari Agim Bahtiri, nënkryetari Faruk Mujka, drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, njëherësh ish-komandant i Brigadës 141 "Mehë Uka", kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së në Mitrovicë, Rafet Ibishi, ai i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, bashkëluftëtarë, familjarë dhe personalitete të tjera. Me këtë rast, kryetari Bahtiri, pasi ka përhëndetur të pranishmit, ka thënë se rikujtimi i këtyre ngjarjeve historike tre-



gon luftën e drejtë dhe të ndershme që kanë kryer ushtarët e UÇK-së, veçmas ata të rajonit

të Shalës. "Falënderoj të gjithë njerëzit të cilët kanë luftuar burrërisht, duke treguar

gatishmëri luftarake për t'i dalë në mbrojtje vendit tonë. Këta njerëz iu treguan të

gjithëve se dinë ta mbrojnë vendin e tyre, pavarësisht rreziqeve nëpër të cilat kalojnë. Andaj lavdi për të gjithë ata të cilët luftuan dhe ranë heroikisht për këtë vend", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, njëherësh ish-komandant i Brigadës 141 "Mehë Uka", Hysni Ahmeti, ka falënderuar të gjithë bashkëluftëtarët e tij për kontributin dhe vendosmërinë e tyre për ta mbrojtur vendin, pavarësisht nga sulmet e ushtrisë serbe dhe presionet që kanë pasur nga bashkësia ndërkombëtare.

Në fund të këtij manifestimi është shfaqur edhe filmi dokumentar "Shkëmbimi", me regji të Fazli Muharremit, ku janë pasqyruar ngjarjet historike të luftës nga ushtarët e UÇK-së të Brigadës 141 "Mehë Uka".

Fillon rrënimin e objekteve pa leje në Vushtrri

VUSHTRRI, 8 JANAR (ER) - Komuna e Vushtrrisë ka lidhur marrëveshje me Kompaninë Regjonale të Mbeturinave "Uniteti" për rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje në këtë komunë. Me këtë rast, Komuna e Vushtrrisë ka njoftuar se Drejtoria e Inspeksionit do t'i rrënojë ndërtimet pa leje në gjithë territorin kësaj komune. "Ju njoftojmë se Komuna e Vushtrrisë ka lidhur marrëveshje me KRM 'Uniteti' për rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje në Komunën e Vushtrrisë. Drejtoria për Inspeksione do të veprojë bazuar në detyrat dhe përgjegjësit që ka ku, ndër të tjera, hyn

edhe rrënimin e ndërtimeve pa leje në gjithë territorin e Komunës së Vushtrrisë. Me këtë rast edhe një herë kërkojmë nga të gjithë qytetarët që të bashkëpunojnë me ne, duke na informuar për ndërtime ilegale, me qëllim që të vëmë rregull në komunën tonë. Inspeksioni komunal është duke i kryer detyrat e veta gjatë gjithë kohës, por neve na duhet edhe bashkëpunimi juaj për të pasur një qytet që duam. Të gjitha pasojat eventuale gjatë rrënimin do të barten nga vetë shfrytëzuesit e objekteve të ndërtuara pa leje", ka njoftuar Komuna e Vushtrrisë, e cila drejtohet nga Xhafer Tahiri.



Komuna e Klinës dhe KFOR-i pajtohen për vazhdimin e bashkëpunimit

KLINË, 8 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka pritur të mërkurën në takim komandantin e Regjionit të Perëndimit të KFOR-it, kolonel Natale Gatti, me të cilin kanë diskutuar për të arriturat, prioritetet dhe sfidat me të cilat përballen Komuna e Klinës.

Kryetari Elezaj ka falënderuar kolonelin Gatti për vizitën e realizuar dhe për bashkëpunimin e realizuar ndërmjet KFOR-it dhe Komunës së Klinës, duke e vlerësuar shumë të rëndësishëm për ofrimin e sigurisë. Më

tutje, Elezaj e ka informuar kolonelin Gatti për të arriturat që ka pasur Komuna e Klinës gjatë vitit që lamë pas, por edhe për prioritetet dhe sfidat që e presin gjatë vitit 2020.

Ndërsa koloneli Gatti, duke uruar kryetarin Elezaj për një vit të mbarë në aspektin profesional dhe personal, ka theksuar se bashkëpunimi ndërmjet KFOR-it dhe Komunës së Klinës do të vazhdojë. Në fund të takimit, koloneli Gatti ia ka dhuruar kryetarit Elezaj simbolin e KFOR-it të regjionit të perëndimit.



A mund të shkojë Kosova drejt zgjedhjeve të reja?

Nga Bedri ISLAMI

Kushdo që e ka menduar se koalicioni në mes të Albin Kurtit dhe Isa Mustafës, pra në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, do të ishte diçka e thjeshtë, e zakonshme dhe që do të kalonte shpejt, tani do të ketë filluar ta ndjejë zhgënjimin. Si është thënë prej kohësh, hesapet e shtëpisë nuk dalin kurrë në pazar e aq më pak dalin hesapet e partive politike kur fjala është për pushtetin.

Votimet e parakohshme të 6 tetorit treguan se njerëzit në Kosovë nuk donin të jetonin më nën një bashkësi qeverisje së cilës jo vetëm i kishte mbaruar koha, por as që ishin në gjendje të thërrisnin një kohë të re. Por ata treguan edhe se besimi tek të paprovuarit ishte ende i pasigurt dhe se besimi ndaj tyre do të ishte ndëshkim ndaj pushtetit. Tingulli i fitores së 6 tetorit është shuar prej kohësh, trumbetarët u bien borive duke dashur ringjalljen e vetvetes më shumë se të tjerëve dhe ajo që ishte dukur e lehtë, joshja ndaj pushtetit, tregoi se do të ishte shumë më e vështirë nga sa pritej.

Isa Mustafa është një njeri i rrahur me politikë që nga fundi i viteve '80, kur do ta merrte edhe pagëzimin e parë politik në një qeveri hije të Kosovës, nën sundimin e Millosheviqit.

Në atë kohë Albin Kurti dhe vetëvendosësit e tjerë pranë tij ishin gjimnazistë të viteve të para, apo edhe më tej, filloristë. Isa Mustafa e di politikën, jo si artin e të mundshmes, por si artin e përfitimit maksimal dhe nuk ia ndien fort për programe politike dhe idealistë të një kohe që nuk është e tij. Ndryshe nga të rinjtë e mbledhur rreth Kurtit, ai ka pranë vetes një grup politikanësh që kanë pragmatizmin si shenjë dhe kompromisin përfitues si qëllim.

Diferencat mes dy grupimeve, që i ndan veç një deputet më shumë, janë shumë më tepër se një; ata nuk kanë të bëjnë vetëm me drejtimit politike apo ideologjitë që mund të bartin, por me gjithçka që ka të bëjë me politikën. Kurti, që e di fare mirë këtë për dallim idesh dhe vizioni, mendoj se ishte një ngushticë lehtësisht e kalueshme, dhe që do të mjaftonte ta tundte flamurin e pushtetit për t'u hedhur të gjithë pas tij. Jo rrallëherë ai e ka sulmuar Isa Mustafën, kryeministër, e jo pa të drejtë, e më shumë se kaq e ka sulmuar si njeriu që vendosi përmes kompromisit Hashim Thaçin në

zyrën presidenciale, njeriun që nuk e njeh si president, që nuk e do si president dhe që do të përpiqet që sa më shpejt ta largojë nga zyra presidenciale.

Në dukje, pikërisht kjo zyrë është molla e sherrit mes dy partive politike, fituese në zgjedhje, por që nuk kanë pasur një fitore spektakolare që ndjell një fillësë të re. Si duket, LDK-ja dhe Isa Mustafa kaq furishëm duket se po kapen pas postit presidencial saqë gjithë të tjerat janë të parëndësishme. Mjegulla e krijuar, paqartësitë, deklaratat kontradiktore, mesazhet vizive dhe sociale, mungesa e kontaktit, zgjedhja e kryetarit të parlamentit, si një alibi e fitores, rreshtimi i njërës palë në Pol Position dhe e tjetrës në pritje të nisjes, flamurët që sillen e përcillen, zëdhënës që futen në lojë, bashkë me analistë që tunden nga era e pushtetit, mbledhje kryesish dhe grupe parlamentarësh, kur gjithçka është në duart e liderëve, pastaj deklaratat të tjera, takime dhe pritje pa fund, të gjitha këto kanë sjellë mjegullën që nuk po do të largohet.

Ndasitë e deritashme dhe sidomos kërkesa ngulëmbëse e Lëvizjes Vetëvendosje për t'i numëruar votat e manipuluar të ardhura nga Serbia, që rritnin numrin e deputetëve të tyre artificialisht dhe linin jashtë Kuvendit partinë Nisma të Limajt, mosmarrëveshjet për ndarjen e posteve, rendja pas cic-miceve politike dhe pasiguria për të ndërtuar një qeveri të përbashkët që, edhe nëse krijohet, do të jetë nga më të ndryshmet dhe të pasigurtat në Kosovë, të gjitha kanë krijuar enigmat e tyre, disa nga të cilat, jo shumë larg, do të jenë të njohura.

A do të ketë një qeveri të përbashkët LV-LDK dhe mbi cilat baza do të ngrihet ajo? Do të jetë në qendër të saj programi politik i LV-së, i cili, në thelbin e tij ndryshon thellësisht nga ai i LDK-së, apo do të ketë një kompromis për të gjetur një mesore të artë, që nuk mund të gjendet? Do të jetë ende agresiviteti i justifikuar ndaj korrupsionit një prioritet qeverisës dhe a do të lejojë LDK-ja që tehu i kësaj lufte të bjerë edhe mbi ish-drejtnesit e saj apo, mos më keq, edhe në këtë rast do të ketë një kompromis përmes të cilit do të ketë alibi politike për qeveritarët lëdëkëistë dhe e gjitha do të jetë rreth strukturës politike, të njohur si PAN? A do të ishte ky kompromisi më i madh i një lëvizje politike që nuk e njeh kompromisin, të paktën si shpallje tani për tani dhe si veprim në ditët e qeverisjes.



Janë shumë mundësi që, të joshur nga pushteti, përfitimet prej tij dhe alibia e së nesërme, LDK, pasi të ketë marrë më shumë nga sa kërkon të afrojë LV-ja, të jetë në qeveri, por a do të mjaftojë kjo ndarje postesh, të jep pesë, më jep pesë, sikur të ndahen kallëp byrekësh? Po sikur LDK-ja të afrojë për ministra figura të lidhura me të shkuarën dhe sidomos me klanet serbe në Kosovë, a do të kishte pranuar, ta zëmë, ministri e planifikuar e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, mbesa e veprimtarit të shquar, Ahmet Haxhiu, të jetë rreth një tryeze me të dhe të kenë një udhë të përbashkët politike? Po me një kabinet ku mund të delegohen figura të vjetra qeverisëse, të cilat LV-ja i ka sulmuar shpeshherë?

A duan të qeverisin? Ka një zvarritje të ndjeshme, më shumë se tremujore, për krijimin e qeverisë së re. Ka rreth gjashtë muaj që Kosova ka një qeveri kalimtare, të dorëhequr. Është pritur që kryeministri i ardhshëm i Kosovës, Albin Kurti, do të jetë njeriu që do të bëjë sa më shpejt kalimin e qeverisë nga një gjendje amorfe në një qeveri efikase. Zemërimi i Kurtit me Hashim Thaçin, një zemërim i vjetër politik që më shumë ka lidhje me të djeshmen se me të sotmen, përplasjet në një institucion që nuk është as i Kurtit dhe as i Thaçit, në presidencë. Takimi formal, pak minutash, një përpjekje për të hedhur ujë në një zjarr që e kanë vetëndezur, sarkazma politike e një shoqëruesi të tij, platformat e munguara, takimi për një shtrëngim duarsh pas një refuzimi të trefishtë, caktimi i datës nga njeriu që pritet t'i sendërtojë të plota institucionet e Kosovës, si në një garë inatësh, se kush është më i fortë, mëria presidenciale 48-orëshe, që fut Kosovën në një rreth pafund, heshtja e shefave partiakë dhe hezitimi, ta sjellë ndër mend pyetjen: duan apo nuk duan të qeverisin?

Të sillsh si çunak në politikë, pavarësisht se je pjesë e saj prej më shumë se 20 vjetësh; të sillsh

si padron i politikës kur, në fakt, për vetë të shkuarën në një regjim antishqiptar nuk duhej të ishte fare njeri i politikës dhe aq më tepër drejtues i forcës së dytë politike; të mos takohesh veçse në momentin e fundit, kur gjërat duket se mund të dalin jashtë kontrollit, kanë dy shkaqe themelore: ose nuk e do këtë qeverisje, ose tashmë loja ka kaluar nga vizioni dhe idealizmi tek loja pragmatike, e cila bëhet e padurueshme, sidomos kur në skakierë janë njerëz të afishuar si idealistë, të vetmit idealistë të Kosovës.

Megjithëse Albin Kurti ka deklaruar disa herë se jemi të gatshëm për qeverisje, ai e di fare mirë se nuk mjafton vetëm gatishmëria e tij për të qeverisur dhe as deputetët e tij. Duhet të shohë përtej gardhit, ku ata që mund të vendosin, pak herë mendojnë me kokën e tyre dhe ku dinjteti politik është i nëpërkëmbur. A do t'i nënshtrohet edhe Kurti kësaj "gatishmërie" për qeverisje? Nisur nga deklaratat e tij politike - kjo nuk do të ndodhë kurrë; nisur nga ajo që po ndodh në pasvijën e politikës, gjithçka është e mundur, megjithëse e padëshiruar! A do të mund të çmontohet mafia politike dhe financiare që ka zaptuar Kosovën në shumë sektorë të saj... nëse në qeveri do të jenë njerëzit e saj? A ka ndikim mafia politike dhe financiare, lobi serb në Kosovë, në zvarritjen e ndërtimit të qeverisë, për të shkulur nga Kurti gjithçka që mund të shkulet dhe për ta krijuar idenë e mosdashjes së qeverisë së re?

A mund të shkojë Kosova drejt zgjedhjeve të reja, po ashtu të jashtëzakonshme, thjesht nga mungesa e një qeverie të sotme ose nga një rrëzim i saj në një ditë tjetër?

Si shënova, fitorja e dy forcave politike opozitare, LV-ja dhe LDK-ja, nuk ishte as spektakolare dhe as e jashtëzakonshme. Pas një qeverisje kaq të gjatë, kaq problematike dhe aspak të njësuar, gjëja më e zakonshme është rotacioni politik dhe në qeverisje. Nuk ndodhi asnjë përmbysje dhe, më shumë se nga jashtë, qeverisja e deridjeshme u dëmtua nga brenda. Ata që u ngutën të thërrasin

"urra" dhe të tjerët që u dëshpëruan, tani do të jenë qetësuar. Jam i bindur se LV-ja ka pritur shumë më tepër se kaq dhe tani, kur lojërat politike po synojnë të mos bëjnë një qeveri, e aq më tepër një qeveri parimesh dhe vizionesh, dëshira duhet të jetë për zgjedhje të reja ose, të paktën, shtyrjen e mandatimit të një kryeministri të ardhshëm, derisa kompromisi të jetë i plotë por, tashmë jam i bindur, në dëm të Lëvizjes Vetëvendosje.

Rikthimi në zgjedhjet të parakohshme do të jetë dëmi i Kosovës dhe koha e humbur e saj. Edhe pas tyre, ndryshimet në mendësinë e votuesve do të jenë të vogla dhe jo përmbysëse. Të dy liderët e dinë këtë.

Në deklaratat e herëpashershme të Kurtit objekt kanë qenë edhe liderët e LDK-së, sidomos në krijimin e qeverisë Mustafa dhe vendosjen e Thaçit në postin presidencial. Asaj kohe LV-ja i lëshoi të gjitha bateritë ndaj kësaj force politike, e cila bëri kompromisin më të papritur dhe ende enigmë politike.

Marrëdhëniet mes Kurtit dhe Mustafës kanë qenë gjithnjë të tendosura dhe herë-herë deri në kufirin e armiqësisë. Të ardhur nga rryma të kundërta politike, nga vizione të ndryshme e shpeshherë të kundërta, njëra palë e provuar dhe e dështuar në qeverisje dhe, tjetra, ende e paprovuar, por shpresëdhënëse, ata e kanë parë njëri-tjetrin jo si bashkëpunëtorë në rrëzimin e qeverisë, e as si rivalë potencialë, por si dy njerëz që duan ta zhbëjnë figurën politike të njëri-tjetrit.

Duke iu referuar figurës së Isa Mustafës, Kurti, jo shumë kohë më parë, ka cilësuar se "Unë nuk mund të ofendohem prej dikujt ndaj të cilit s'kam respekt. Unë nuk kam respekt për të".

Më 26 shkurt 2016, në ditën kur Hashim Thaçi u zgjodh president i Kosovës dhe Isa Mustafa ishte shef i qeverisë, opozita e asaj kohe, Lëvizja Vetëvendosje, protestoi dhe hodhi bomba molotovë mbi shtëpinë e liderit të LDK-së.

Mustafa atëherë deklaroi se: "Unë jam kryeministër i vendit, nuk jam shenjë që kujt t'i teket të gjuajë në mua dhe mendoj që këtë s'duhet ta lejojnë organet e drejtësisë, që të më sulmohet shtëpia. S'kam dashur që të deklarohem publikisht, por, në qoftë se një shtëpi e kryeministrit sulmohet me koktej molotovi, atëherë këtu diçka nuk është në rregull".

Edhe ditët e tashme tregojnë se akulli ndërmjet tyre nuk është shkrirë dhe se akullimi mund të vazhdojë gjatë. Askush nuk do të jetë i fituar.

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Prëzohet avioni ukrainas në Iran, 176 të vdekur

TEHERAN, 8 JANAR - Një aeroplan ukrainas me 176 njerëz në bord, u rrëzua të mërkurën afër aeroportit Imam Khomeini në Teheran, njoftuan televizionit shtetëror iranian dhe udhëheqësit ukrainas. Aeroplani Boeing 737, pronë e kompanisë Ukraine International Airlines, që ishte nisur për në Kiev, u rrëzua afër aeroportit dhe u përfshi nga flakët. Ambasada ukrainase në Iran, tha se në bazë të hetimeve paraprake, aeroplani kishte

probleme teknike dhe rrëzimi i tij nuk ishte pasojë e ndonjë "sulmi terrorist". Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, tha se askush nuk ka mbijetuar. "Ngushëllimet më të sinqerta për të afërmit dhe miqtë e udhëtarëve dhe pjesëtarëve të ekuipazhit", tha presidenti Zelenskiy në një deklaratë duke shtuar se Ukraina po punon për të marrë vesh rrethanat e rrëzimit të aeroplanit. Të dhënat e fluturimit tregojnë

se aeroplani u ngrit nga aeroporti të mërkurën në mëngjes dhe pothuajse menjëherë e ndali dërgimin e të dhënave, sipas faqes së internetit FlightRadar24. Televizioni iranian tha se rrëzimi ishte pasojë e problemeve teknike por pa dhënë hollësi të tjera. Sipas televizionit shtetëror, një nga dy kutitë e zeza tashmë është gjetur. Rrëzimi ndodhi disa orë pasi Irani ndërmoi një sulm me raketa balistike që kishin në




shënjestër dy baza në Irak ku janë stacionuar trupa nga ShBA-ja, në shenjë hakmarrjeje për

vrasjen e gjeneralit të Rojave Revolucionare, Kasem Soleimani.

Demokratët kritikojnë vendimin e presidentit Trump për vrasjen e Kasem Soleimani

Kandidati demokrat për president, Joe Biden, dhe kundërshtarët e tij demokratë e kritikuan ashpër vendimin e presidentit Trump për vrasjen e komandantit ushtarak iranian Kasem Soleimani, duke paralajmëruar pasoja



WASHINGTON, 8 JANAR - Kandidati demokrat për president, Joe Biden, e quajti presidentin Donald Trump të "rrezikshëm dhe jokompetent" pas urdhrit për vrasjen e komandantit ushtarak iranian Kasem Soleimani. Bideni dhe kundërshtarët e tij demokratë e kritikuan ashpër vendimin e presidentit, duke paralajmëruar pasoja. Kandidati demokrat për president Joe Biden, kritikoi presidentin Trump dhe paralajmëroi për pasoja të vendimit për sulmit ku u vra komandanti iranian Kasem Soleimani, ka njoftuar voa. "Presidenti Trump nuk ka një strategji, ashtu më duket. Ai nuk ka një plan përfundimtar dhe kjo është e vërteta më e rëndë. Ai vazhdimisht gabon dhe këto vendime u lënë Shteteve të Bashkuara më pak mundësi për të lëvizur përpara", tha kandidati

demokrat për president, Joe Biden. Bideni tha se presidenti duhet gjithashtu të kërkojë autorizimin e Kongresit për përdorimin e forcës. "Zoti President, jeni i detyruar të bashkëpunoni me Kongresin. Duhet të veproni në pajtueshmëri me Rezolutën për Kompetencat e Luftës. Nuk mund të nxisni luftë me Iranin pa konsensus dhe miratim të Kongresit", tha ai. Edhe rivalët e Bidenit, si Bernie Sanders, ishin kritikë ndaj veprimeve të presidentit. "Roli i Shteteve të Bashkuara, sado i vështirë të jetë, është që të punojë me komunitetin ndërkombëtar që konfliktet dhe kërcënimet për luftë të marrin fund, e jo të nxitet lufta siç po bën presidenti Trump", tha Bernie Sanders, kandidat demokrat për president. Senatorja Amy Klobuchar, kandidatë tjetër presidenciale, shprehu

po ashtu shqetësim. "Jam e shqetësuar nga përdorimi i tepruar i forcës nga presidenti dhe nga një vendim që mund të nxisë përshkallëzim të konfliktit", tha ajo. Kandidati tjetër demokrat, Pete Buttigieg, nga Ajova foli për sulmin në Irak. "Të kesh përgjegjësi udhëheqëse në botë, nuk nënkupton të zgjidhësh çdo

problem me forcë ushtarake. Duhet përdorur mjetet diplomatike, ekonomike, sociale e informative dhe vetëm kur nuk ka rrugë tjetër përdoren mjetet ushtarake, që të mbrohen interesat dhe vlerat që ne ruajmë dhe ndajmë me të tjerët në botë", tha Pete Buttigieg, kandidat demokrat për president. Ndërkaq, presidenti Trump ka


vazhduar ta mbrojë vendimin e tij për vrasjen e Soleimani. "Ai quhej përbindësh dhe ishte i tillë. Më nuk është përbindësh. Është i vdekur dhe kjo është gjë e mirë për shumë vende", tha presidenti. Tensionet me Iranin vijnë pak javë përpara votimeve të para për kandidatin demokrat për president, që mbahen në Ajova më 3 shkurt.

Putini dhe Erdogani inaugurojnë gazsjellësin Rrjedha turke

ANKARA, 8 JANAR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tayip Erdogan dhe homologu i tij rus, Vladimir Putin, kanë inauguruar gazsjellësin Rrjedha turke, që do të hapë një rrugë të re eksporti për gazin rus në Turqi dhe Evropë. Gazsjellësi është një shenjë e bashkëpunimit dhe bashkëpunimit për të mirën e popullit tonë dhe njerëzve të Evropës dhe gjithë botës", tha Putini në ceremoninë e inaugurimit. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan, ka kohë që kërkon të kthejë vendin e tij në një qendër energjetike. Rrjedha turke është një projekt që

është zhvilluar në pesë vitet e kaluara dhe ka një kosto prej afro 8 miliardë dollarë. Gazsjellësi do të transportojë gaz rus në Turqi, me gjysmën e vëllimit që rrjedh më tej në Ballkan dhe Evropën Qendrore, përfshirë Bullgarinë, Serbinë dhe Hungarinë. Projekti është pjesë e qëllimit afatgjatë të Rusisë për të zvogëluar ose përfunduar transitin e gazit përmes Ukrainës. Putini udhëtoi në Turqi nga Siria kur zhvilloi bisedime me presidentin sirian Bashar al-Asad. Në ceremoninë në Stamboll, do të marrë pjesë edhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka njoftu-

ar kabineti i tij. Gjatë vizitës, Vuçiqi do të takohet me presidentin turk Erdogan, atë rus Putin dhe kryeministrin bullgar Boyko Borisov. Ky tubacion është pasardhësi i projektit të tubacionit Rrjedha jugore, ndërtimi i të cilit u braktis nga Rusia në dhjetor të vitit 2014 sepse nuk mund t'i respektonte rregullat e Bashkimit Evropian, sipas të cilave një kompani nuk mund të zotërojë si gazin ashtu edhe tubacionin. Tubacioni i ri i gazit ka ngritur shqetësime në Komunitetin e Energjisë pasi Agjencia e Energjisë e Serbisë lëshoi një vendim përfundimtar më 5 mars



2019, duke përjashtuar tubacionin e ri nga rregullat e BE-së dhe duke mos përmbushur të

gjitha kushtet e përcaktuara nga Komuniteti i Energjisë si një organ rregullator evropian.

“Kthimi i profetit”, një metanarrativë njerëzore

Nga Shqipe ELEZI

Autori përballë utopisë

"Kthimi i profetit" i autorit Adil Olluri është libri i fundeve, i përmbysjes së ideologjive, i mbarimit të historisë por edhe i realitetit. Përmes këtij libri është krijuar një grusht i fortë që i mëshon shoqërisë mu aty ku i dhemb më shumë e shpesh denjon ta pranojë këtë të vërtetë paradoksale të shekullit XXI. Si jetohej në këtë shekull në Kosovën e autorit? Çfarë pasojash ka lënë e kaluar në të tashmen e ç'na pret në të ardhmen? Rrëfimet e këtij libri e vënë njeriun përballë utopisë.[1] (Gashi)

Kamxhiku i Ollurit godet këdo, pa mëshirë dhe pa hatërmbetje. Ndonëse i vogël për nga vëllimi, "Kthimi i Profetit" është i bujshëm për nga tematika. Në të gërshetohen tragjikja me komiken, mbijetimi i njeriut në jetën e sistemin e sotkrijuar, mosvlerësimi i jetës njerëzore dhe rrekja e pafundme nëpër rrëpirat e pushtetit e sistemit vetëm për pozita shoqërore e para. Gjatë leximit fillon të dyshosh se a jetojmë vërtet në demokraci, a jemi në shekullin e XXI a në errësirën mesjetare? Apo ndoshta diktaturat s'marrin fund kurrë por thjesht transformohen?!

Struktura dhe loja me 'mëkatet'

Libri përbëhet nga tetëmbëdhjetë tregime që shumica nuk kanë lidhje mes veti. Personazhet

janë të ndryshme dhe në secilin tregim flitet për një temë të caktuar përmes së cilës autori e sulmon shoqërinë. Ngjarjet vendosen herë në kryeqytetin e Kosovës, herë fshatrave të saj, herë dhomave luksoze të hoteleve, herë bankave shtetërore e herë maleve a fushëbetejave të luftës. Përmes këtyre tregimeve secili personazh rrëfen tragjikomedinë e vet, qarkoren e jetës së tij nga e cila s'mund të dalë dhe s'i mbetet zgjidhje tjetër veç të bëhet njësh me tufën, me fenë, me sistemin, me politikën, me krimin, me korrupsionin, shtetin... Tregimet që janë vendosur në fillim me titujt "Barku i balenës", "Sheshi i ndryshuar", "Kthimi i profetit", janë tregime në të cilat krijohet lojë me referenca religjioze.

Autori nxjerr në fushëbetejë njeriun përballë fesë, që e beson por s'di asgjë në lidhje me të, ai hipotezon e dyshon vazhdimisht, thotë se besimi pa njohje është xhahillet. E vetëm përmes pyetjeve mund të arrijmë te njohja. [2] Olluri e kthen edhe njëherë profetin Muhamed në Prishtinë, ai është si të tjerët, joshet nga e bukura dhe mëkaton njëloj si njerëzit. Keqinterpretimin e fesë, të cilën ai e ka krijuar, e hasim në xhami, ai tregon se është profeti por e marrin si të marrë e kur bërtet se njerëzit e besojnë dhe i luten Zotit vetëm sepse kanë frikë nga Ai e jo nga dashuria që ndiejnë, atëherë profetin e flakin jashtë xhamisë.

Januzi që qëndroi tri ditë e tri net në barkun e balenës[3], kthehet në ditët e sotme por nuk e ripërtërin historinë nga libri i shenjtë, ai mëkaton, tundohet



aq fort nga një femër sa harron martesën e fëmijët dhe zhytet në epshet njerëzore që falin kënaqësi. Kur kthehet në shtëpi aq mistershëm sa u largua, gënjën duke thënë se ka qenë në barkun e balenës.

Tregimi me titull "Sheshi i ndryshuar" është një proleksë përmes së cilës e ndërton ardhmërinë, shkuljen e kombëtares përpara fetares duke harruar se kombi është mbi të gjitha. Këtu flet për shembjen e idhujve kombëtarë, burgimin e intelektualëve dhe ardhmërinë e errët kur në pushtet do të vijë feja e do të udhëheqë me shoqërinë.

Tregimet tjera flasin për hipokrizinë njerëzore e shoqërore, që duhet të vdesësh e

më pas të të duan se po të jesh në jetë s'mund të të mposhtin dot ("Funerali im"), që mediet e sotme ("Vdekja e autorit") të bëjnë lajm e shpifin për ty, qoftë kjo edhe për mënyrën si ke vdekur, që teatri shoqëror dhe marionetat e pushtetit vazhdojnë të shpifin e të përflasin cilindo a cilëndo e në këtë rreth shoqëror, ku gjithçka është kokëposhtë ("Rrëfimi im personal") vetëm një person ndryshe nga kjo shoqëri mund të gjejë një strehë ku të jetë vetja, e jo kokëposhtë.

Populli, sado që të revoltohet është i vogël përballë pushtetit, ai s'e ka përjetuar lirinë dhe nuk di si të veprojë e si të silltet në liri prandaj prapë kthehet në zgjedhën e robërisë e të pushtetit që kështu së paku të ketë bukë për të ngrënë. Intelektualëve të sotëm duart ua pret sistemi e pushteti, e ata duhet të shkruajnë e t'i përshtaten atij, në të kundërtën e harrojnë ëndërrën për të cilën punuan aq shumë. E pushteti ka spionët e tij kudo dhe xhelatët e tij mbijnë si kërpudhat pas shiut për të vrrarë viktimat. Kjo lloj shoqërie që kemi krijuar ka mbirë brenda nesh jonjerëzoren, që vret mikun për t'i marrë gruan a pushtetin, që sa është paradoksale aq edhe ironike, që sado e kritikojmë aq më shumë e pranojmë, sado e mohojmë natën fshehurazi bëjmë planet si të dashurohet kjo shoqëri në mua e të jem unë sunduesi. Autori përmes sarkazmës, ironisë dhe alegorisë ("Revolta e minjëve", "Kthimi i sërishëm i drerit në kopshtin zoologjik") kritikon, provokon, parodizon secilën hallkë të sistemit që është ngritur e jetës shoqërore që jetojmë,

e për krijimin e këtij sistemi si fajtor e sheh vetë njeriun, që luftoi aq shumë për atdheun por s'krijoi atë që u prit aq shumë e u ëndërrua aq fshehurazi.

Olluri është një Kafkë që krijon procesin e gjyqit kafkian në Kosovë, e për përfundimin e gjyqit na flet në "Sheshin e ndryshuar". Ai është pasqyra ku secili shqiptar e gjen veten, e përmes këtij libri synohet edhe revolta, jehon në të thirrja "Zgjuhu o popull, se është koha për ndryshim".


Një metanarrativë njerëzore

"Kthimi i Profetit" është një metanarrativë njerëzore e së tashmes, ku secili tregim shpallon një jetë personazhi e cila sado na duket personale, trajton tema ngacmuese e intriguese dhe përfundon duke u universalizuar aq sa secili e gjen veten pjesë të këtij a atij tregimi. Vetëm përmes revoltës do të mundnim shpëtonim nga sunduesit dhe t'i jepnim fund një metanarrativë njerëzore shqiptare. Ndonëse vepra do të kënaqte maksimalisht edhe një lexues semantik, do të ngacmonte ende më shumë erudicionin e një lexuesi semiotik. E vepra e Ollurit fillon pikërisht në momentin kur mbyll librin. /Exlibris

[1] Agron, Gashi: <https://gazetaletrare.com/olluri-sjell-profetin-muhamed-ne-prishtine-agron-gashi/>, 10 dhjetor 2019

[2] Adil, Olluri: Kthimi i profetit, Armagedoni, Prishtinë, fq.16


[3] Histori nga Kurani për profetin Junuz, një histori e tillë e ngajshme ekziston edhe në Biblën hebreje



E rrallë

Droni-satelit, mjeti fluturues më i madh në botë

Një avion gjigant, me tre bishta e me vetëm njërin krah sa një avion pasagjerësh, është më shumë si dron, por mund ta bëjë punën e satelitit. Mjeti fluturues, që furnizohet me energji diellore, mund të qëndrojë në ajër për tre muaj rresht në mënyrë autonome. Avioni i quajtur "Odise" po zhvillohet nga kompania



Boeing dhe do të jetë një nga mjetet më të mëdha fluturuese të ndërtuara ndonjëherë, e që nuk do të komandohet nga njerëz në bord.

FOTO E DITES



Makina dhe njerëzit rrethojnë devetë për shitje gjatë Festivalit Vjetor të King Abdulaziz Camel në Rumah, rreth 160 kilometra në lindje të Rijadit. /AFP/

E jashtëzakonshme

Në Gana njerëzit varrosen me arkivole artistike

Të afërmit besojnë se të vdekurit duhet të largohen në mënyrën më të mirë të mundshme, ndaj funeralet në Gana janë çështje të sofistikuara. Duke qenë se burimi kryesor i të ardhurave në këtë zonë është bima e kakaos, shumë fermerë kërkojnë që të varrosen në arkivole që kanë formën e lëvozhgës së frutit të kakaos. Dhe këto arkivole kushtojnë jo pak, por



pothuajse 1 000 dollarë, një shifër tepër e lartë për fermerët që fitojnë rreth 3 dollarë në ditë. Por të varrosesh me një arkivol artistik është aq e rëndësishme sa ndodh shpesh që të afërmit bashkojnë paratë për ta varrosur dikë siç duhet.

BARSOLETA E DITËS



Nëna e pyet djalin: Çka ka ndodhur në vitin 1405?
Djali: Lindi Skënderbeu.
Nëna: Po në vitin 1409?
Djali: Skënderbeu i bëri 4 vjet.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

1 Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.
Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

<p>DASHI Lajmet e këndshme do ta gjallërojnë ditën. Lejoni spontanitetin dhe hipotezën e një ndryshimi të perspektivës, pa dyshime dhe pa hezitim!</p>	<p>DEMI Shfrytëzoheni sa më shumë këtë ditë. Hëna është e favorshme për ju dhe jo vetëm. Do të bëjë gjithçka për t'ju kënaqur dhe për t'ju dhënë një ditë të këndshme.</p>	<p>BINJAKËT Është koha për të vepruar sepse do të favorizoheni nga një fat shumë i madh. Sillni në jetë një projekt dhe do të rriteni shumë profesionalisht.</p>	<p>GAFORRJA Ju nuk do të ndiheni shumë në formë ditën e sotme, kështu që merreni shtruar. Mos e teproni me aktivitet sportive.</p>	<p>LUANI Ju do të keni një zbrazje të kartës bankare, por mund të kapeni pas diçkaje pozitive që dita e martë t'ju ecë mirë.</p>	<p>VIRGJËRESHA Nëse dëshironi të bëni një hap cilësor në punë, do t'ju duhet të përmbaheni në përpikërinë maksimale, gjë që mund ta bëni shumë lehtë.</p>
<p>PESHORJA Në punë do të arrini disa marrëveshje të mira dhe në mbrëmje do të argëtoheni duke takuar njerëz të rinj.</p>	<p>AKREPI Sot do të shumëfishohen aftësitë tuaja operacionale, duke ju bërë të ndërhyni me vendosmëri në situata kur nuk ka qartësi ose informacion të duhur.</p>	<p>SHIGJETARI Hëna dhe Neptuni do t'ju shkaktojnë disa probleme në çift. Kujdes, rrezikoni ta shkatëroni marrëdhënien me partnerin për disa grindje që vijnë nga arsye të kota.</p>	<p>BRICJAPI Ekzistojnë disa mundësi për të bërë një ndryshim interesant në aspektet më konkrete të jetës suaj.</p>	<p>UJORI Ditë e shkëlqyer! Një valë rinovimi po hyn në punë, e dobishme të realizuar një projekt që e keni dashur kaq shumë për një kohë të gjatë.</p>	<p>PESHQIT Përhapeni sjelljen tuaj të ndritshme te të huajt dhe miqtë ashtu dhe bëjeni që kjo ditë të jetë e shkëlqyeshme.</p>

Kellan Lutz thotë se dëshiron të ketë familje të madhe



Aktori i njohur amerikan Kellan Lutz është bërë baba për herë të parë. Ai në një intervistë për "People" ka thënë se është shumë i entuziazmuar që është bërë baba. Lutz, gjithashtu,

pohoi se dëshiron të bëjë një familje të madhe me fëmijë. Aktori i njohur bëri me dije se do të transferohet të jetojë në Nju Jork për shkak të xhirimeve të filmit.

Pink dhe Hart festojnë 14-vjetorin e martesës



Këngëtarja amerikane Pink dhe bashkëshorti i saj Carey Hart janë më të dashuruar se kurrë. Ylli i muzikës pop dhe bashkëshorti i saj, Hart, të mërkurën festuan përvjetorin e 14 të martesës, derisa nuk munguan dedikimet emocionale

ndaj njëri-tjetrit. "14 vjet i martuar me këtë grua të mrekullueshme. Jam shumë i lumtur me jetën që kemi ndërtuar së bashku. Të dy prej neve erdhëm nga shtëpi të ndryshme, por ne punuam shumë për lidhjen tonë", ka shkruar Hart.



Rita Ora vazhdon të kërkojë ndihmë për t'i luftuar zjarret në Australi

Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, ka bërë apel për të ndihmuar në luftën kundër zjarreve në Australi. Nëpërmjet rrjetit social "Instagram", Ora ka ftuar të gjithë që të kontribuojnë duke u lidhur me postimet që ka bërë në "InstaStory". "Zjarret në Australi janë kaq shkatërruese sa që është e pamundur për ne t'i injorojmë.

Ne duhet të ndihmojmë tani. Drejtohuni te historitë e mia dhe shkoni për të dhuruar për Kryqin e Kuq Australian, Shoqatën e Shën Vincent de Paul, Fondin Botëror të Botës së Kafshëve dhe një Fund Go Me për të prekurit. Të gjithë këta njerëz janë duke bërë punë të mahnitshme. Ju lutemi dhuroni aty ku mundeni", ka shkruar Rita.

Kështu duket Adele pas peshës që ka humbur



Këngëtarja e njohur Adele pas një periudhe të gjatë ka humbur disa kilogramë. Ajo deri tani nuk ka bërë me dije akoma se si i ka humbur këta kilogramë apo edhe peshën e saktë sa e ka humbur. Por në

fotografitë të cilat janë duke qarkulluar në rrjetet sociale shihet se ajo ka humbur shumë peshë dhe duket krejt ndryshe. Fotografitë e fundit të Adeles janë kur ishte bashkë me Harry Stalesin për pushime.



						Autor: GAZMEND MORINA	SHUFRA METALIKE TË LIDHURA SI SKELET NDËRMJET TYRE (sh.shq.)	KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)	SHTËPIZË ME DËRRASA (sh.shq.)	AKTORJA ISMAILI	EPOKA E RE	NDENJËSE E GJATË	ZANORE	PREMTIM SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK (sh.shq.)	ASOCIAZIONE NAZIONALE ALOPECIA AREATA	CEREMONI FETARE	EDITA SOPJANI	
						AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE JESSICA					LOKAL NATE ME PROGRAM ARTISTIK PIKË (ang.)							
						SHTET NË AFRIKË							KËNGËTARI POTOKU QYTET I MADH NË GJERMANI					
						KUKULLAT											APARTAMENT (sh.shq.)	
						KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE (shqip.)											BASHKËT. RESTORANT, KAFE	
											PEABODY ESSEX MUSEUM THIKË E VOGËL XHEPI ME NJË PRESE						"LOS ANGELES" ANË E MPREHTË E NJË VEGLE	
						SHKENCA MBI MORALIN ZANORE	ZANORE IDRIZ BALAJ			KLUB BASKETBOLLI NË ITALI KUNDËRSHTARI I BOLSHË-VIZMIT RUS								
						KALORËS MESJETAR						NOTË MUZIKORE	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË CIFTËS PORTIERI LIKA					
EPOKA E RE	FUTBOLLISTI URUGUAIAN NË FOTO (PSG)	TENISTJA SHARAPOVA	I PLOGËT	PESHA E MALLIT PA AMBALAZH	ELVIN ZAJMI	AZEM BEJTA LARTËSI QË ARRIN NJË SIPËRFAQE UJI E LIRË			SHTET NË AZI (pashq.) TERËSIA E VUJAVE QË BËHEN NË NJË ARË PËR TË UJITUR					NDESH FUTBOLLISTI GOKHAN (NAPOLI)				
	I SHQUAR, I DALLUAR							FUTBOLLISTI YNË FREDERIK MËRZEJ; RRI NË HIJE										NOTË MUZIKORE VËNIA E DATËS NË KALENDAR
	BANORI I NJË SHTETI SKANDINAV												BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA SKAJ MAGNETIK (sh.pashq.)				TREVISO VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE	
	IRNOSET (bised.)					KOMPOZITORI ITALIAN XHYZEPE					BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN KËNGËTARJA ANILA							ZYRTARIZIM I NJË MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE (sh.shq.)
	AKTORI AMERIKANE ROBERT DE					KËNGËTARJA ZAHARIA NDODHJE NË NJË VEND TJETËR NË ÇASTIN KUR ËSHTË KRYER NJË KRIM				QË LIDHET ME MONEDHËN FLETORË PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE								
													VARGU I PËRPUTHUR PRONË E VOGËL E SPAHINJVE OTOMAN (shq.)					
	PIKTORI VALLA ZANORE	RAMADAN (perkdh.)	OMANI, LIBERIA E TRAZOJ			VLERËSIM ME NOTË (sh.shq.) INSEKT I MËRZITSHËM (sh.shq.)								KRAHINË NË SHQIPËRI (pashq.) MËNYRË VEPRIMI (shq.)				
	NDJENJË E RESPEKTIT DHE E VLERËSIMIT TË LARTË							GJENDJA FIZIOLOGJIKE E QENIEVE TË GJALLA KËNGËTARI WEBBE (shq.)										I BUKURI (bised.) IRISH FILM INSTITUTE
	LLOJ BIME NARKOTIKE																	EMMA FAZZUOLI REGJISORJA GJONI (shq.)
	ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE																	ZANORE KUNDREJT I FORTI
	BASHKËT.		"KENIA" VIJA QË SHPIE UJIN NË MULLI			KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.) FUTBOLLISTI ABIDAL				TASH	QESËNDISËS ALBANOLOGIA DURHAM							
													JETA E QETË SHKRONJË GREKE					
	PJESA MË E LARTË E NJË MALI QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT																	LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI DUKAT
	VEÇIMI																	INITIATIVE GLOBUS EUROPE ZANORE
EPOKA E RE	SHKENCËTARI NJUTON (shq.)																	UGANDA, TANZANIA

Kundërshtohet zhbërja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Rrjeti i Institucioneve të Pavarura të Artit dhe Kulturës në Kosovë, përmes një kumtese ka kundërshtuar zhbërjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që është përmendur se do të ndodhë në Qeverinë e ardhshme

Përmes kësaj kumtese, RRIPAK përsëritë kërkesën për krijimin e Ministrisë së Kulturës në Qeverinë e re të Republikës së Kosovës.

"RRIPAK thekson edhe një herë që partitë politike duhet të rrisin urgjentsisht vëmendjen për rolin dhe ndikimin shoqëror dhe zhvillimor të këtij aktiviteti të rëndësishëm shoqëror, dhe të fuqizojnë pozitën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore në qeverinë e re për të krijuar një paradigme të re zhvillimore në Kosovë duke trajtuar artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore si interes kombëtar dhe pikë parësore të politikave zhvillimore", thuhet në këtë kumtesë.

Po ashtu ata vlerësojnë se plani për zhbërjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe mos themelimin potencial të Ministrisë së Kulturës në Qeverinë e re të Republikës së Kosovës do të jetë shumë i dëmshëm për interesin publik dhe kombëtar të Kosovës.

"Me zhbërjen eventuale të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe mosthemelimin e Ministrisë së Kulturës, Kosova do të veçohet nga shembujt e politikave progresive në vendet demokratike të Evropës jug-lindore, dhe vendet e Bashkimit Evropian", ka konstatuar RRIPAK gjatë hulumtimeve të bëra. /KultPlus



Studentët ia mësyjnë kurseve private, ligjëratat në UP nuk u mjaftojnë për provime

Në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës është bërë traditë që studentët ta kenë të vështirë t'i kryejnë provimet, rrjedhimisht ata 'detyrohen' të ndjekin kurse private, shkruan Literal Media

Një gjë e tillë tregon kualitetin e 'brishtë' që Fakulteti Teknik, përmes ligjëratave dhe ushtrimeve, ofron te studentët. Për të kuptuar më mirë arsyet pse studentët ndjekin kurse private, Literal Media ka pyetur një prej tyre.

"Lëndët që kanë nevojë për kurse më së shumti janë Bazat e elektroteknikës, Sinjale dhe Sisteme. Nëse nuk kalohet provimi, mundësohet përsëritja e kursit me të njëjtin çmim. Mendoj se asnjë provim nuk është i pakalueshëm vetëm se pa kurse merr kohe shumëfish më shumë. Sa i përket ligjëratave në Fakultetin Teknik, shumica e tyre janë të pamjaftueshme për studentët, disa për shkak të orëve të pakta e disa edhe shkak i profesorëve", ka thënë njëra nga stu-

dentet që ka ndjekur kurse private.

Gazeta ka kontaktuar edhe njërin nga Profesorët që ofrojnë kurse private për studentët e Fakultetit Teknik, i cili tregoi se një nga arsyet pse studentët ndjekin kurse private është mungesa e efektivitetit të ligjëratave në UP.

"Studentët vijnë në kurs në ato raste kur duan ta përfundojnë fakultetin më shpejt. Në rast se edhe pas kursit nuk e kalojnë provimin, atëherë ata konsultohen me neve a ta ndërrojnë drejtimin apo të vazhdojnë përpjekjet"- shtoi Profetori.

Ndërsa Fakultetin Teknik nuk janë në dijeni për këto kurse private;

"Ne jemi në dijeni për kurset private që mbahen në disa lëndë



dhe personalisht e kam diskutuar disa herë me studentët të vitit të parë. Nuk kam arritur me marr asnjë përgjigje e cila do të sinjalizonte se diçka nuk është në rregull me ligjëratat, ushtrimet dhe konsultimet me studentët.

Thjeshtë ndjekin një praktikë, pa asnjë sqarim shtesë. Stafit është në dispozicion për të gjitha kërkesat e studentëve dhe me sa jam në dijeni janë zvogluar dukshëm, por nuk është eliminuar në tërësi. Thënë shkurt, nuk

ekziston arsye e bazuar për kurse të tilla dhe se deri sot nuk kemi pasur asnjë ankesë nga studentët, për ndonjë lëndë të caktuar", tha Enver Hamiti nga Fakulteti Teknik i Universitetit të Prishtinës. /Literal.media

EUROGLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Johni rikthehet në Kosovë me synime të vjetra

Sulmuesi Oto Jon zyrtarisht është rikthyer në futbollin e Kosovës, kurse ambiciet e tij për ta fituar titullin e kampiones sikurse me Trepçën '89 i ka edhe me Prishtinën. "Titulli nuk është i pamundshëm megjithëse diferencat ndërmjet skuadrave nuk janë të mëdha dhe lufta për titull është e ashpër, por besoj se mund të jem Oto edhe më i mirë se te Trepça '89 dhe ta ndihmoj skuadrën drejt qëllimit që ka", ka thënë Johni



EPOKA E ENJTE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 JANAR - Sulmuesi nga Nigeria, Oto John, është rikthyer sërish në futbollin e Kosovës, por kësaj radhe nuk do të djersitë fanellën e Trepçës '89, por të Prishtinës. Klubi nga kryeqyteti ka njoftuar se negociatat për transferimin e sulmuesit John nga Skënderbeu nuk kanë qenë aspak të lehta. Sulmuesi që ka lindur në vitin 1990 ka treguar se e njeh mirë futbollin e Kosovës dhe synimet e tij nuk kanë ndryshuar sikurse vite më parë me Trepçën '89 ta fitojë titullin e kampiones në Superligë. "Do të jap gjithçka nga vetja që t'ua shpaguaj besimin që kanë në mua. Pse jo, të kem paraqitje sikurse para dy vjetësh me Trepçën '89 kur kisha formë të lartë dhe pata ndihmuar të shpallej kampion. Besoj shumë te Prishtina dhe krejt çfarë duhet është të kem edhe pak fat. Titulli nuk është i pamundshëm megjithëse diferencat ndërmjet skuadrave nuk janë të mëdha dhe lufta për titull është e ashpër, por besoj se mund të jem Oto edhe më i mirë se te Trepça '89 dhe ta ndihmoj skuadrën drejt qëllimit që ka", ka thënë John për faqen zyrtare të klubit kryeqytetas. John me fanellën e Trepçës '89 dy vjet kishte shënuar 44 gola dhe ishte shpal-

lur kampion i Kosovës, kurse nuk ka hezitur të tregojë pse e zgjodhi pikërisht Prishtinën për ta vazhduar karrierën futbollistike. "Në Prishtinë vendosa të vij sepse ka ekip të mirë dhe është klub me famë. Kur më ftoi kryetari Remzi Ejupi e pashë një mundësi të mirë që të jap më të mirën për klubin", ka shtuar ai.

John është transferimi i parë i Prishtinës në këtë afat kalimtar, kurse ky klub ka liru këta futbollistë: Agon Xhaka, Art Maloku, Ramush Ramadani, Jon Bajgora dhe Lis Ahmeti. Prishtina është një nga favoritët kryesorë në garën për titull, por edhe për Kupë. Kjo skuadër sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e katërt me 31 pikë, tri pikë më pak se skuadra e parë në renditjen tabelore. Skuadra që drejtohet nga Armend Dallku në çerekfinale të Kupës do të takohet me skuadrën e Vushtrrisë.

Llapi bën goditje të fuqishme në këtë afat kalimtar

Edhe skuadra e Llapit është mjaft aktive në këtë afat kalimtar pasi, përveç transferimeve të tjera, ka arritur ta transferojë edhe portierin italian që ishte pjesë e Sampdorias, Giacomo Nava, i cili ka nënshkruar kontratë për një vit e gjys-

më me skuadrën që drejtohet nga Tahir Batatina. 22-vjeçari, i lindur në Lavagna të Italisë, është reprezentues i Italisë në grupmoshat e reja. Spikasin paraqitjet e tij të shumta duke filluar nga gjenerata U19 e klubit të madh italian Sampdoria. Ka mbrojtur edhe për Lentigione dhe Lecon, kurse në edicionin e fundit ishte pjesë e klubit italian, Riminit. Në karrierën e tij të pasur numëron 113 paraqitje, prej tyre ka 43 ndeshje pa gol të pranuar. Të mërkurën skuadra nga Podujeva e ka prezantuar edhe qendërmbrojtësin nga Shqipëria, Florian Daci. 28-vjeçari sezonin e fundit ishte pjesë e Kastriotit të Krujës, kurse ka luajtur edhe për Tomorin, Turbinën dhe Lirinë e Prizrenit.

Gjilani transferon sulmuesin Darko Nikaq

Skuadra e Gjilanit, pas transferimit të Sebino Plakut nga Llapi, të martën në mbrëmje e ka bërë zyrtarë transferimin e sulmuesit nga Mali i Zi, Darko Nikaq. Futbollisti i lindur në Podgoricë edicionin vjeshtor ishte pjesë e Teutës nga Durrësi, kurse karrierën e kishte nisur në ekipin e Buduqnostit nga Podgorica, por ai ka përvojë edhe në futbollin e Hungarisë, Uzbekistanit dhe Indisë.

SHKURT

Rahoveci përballë liderit në Ligën Ballkanike

KB Rahoveci sonte (e enjte) do të zhvillojë një ndeshje shumë të vështirë në Ligën Ballkanike. "Vreshtarët" do ta presin në shtëpi liderin, Academia Bultex, në takimin që zhvillohet nga ora 19:00. Rahoveci në pjesëmarrjen e parë në Ligën Ballkanike ka një fitore dhe katër humbje, kurse skuadra bullgare ka pesë fitore në po aq ndeshje të zhvilluara. Skuadra kosovare ka bërë disa përforcime për stinorin pranveror, andaj përballja e së enjtes pritet të jetë shumë interesante.

Drin Kokaj dhe Era Shala përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore

Kosova do të marrë pjesë në Lojërat Olimpike Dimërore për të rinj që do të mbahen në Llozanë të Zvicrës nga 9 janari deri më 22 janar. Kosovën në këtë ngjarje do ta përfaqësojnë skitari Drin Kokaj dhe skitarja Era Shala. Ata janë nisur në mëngjesin e së mërkurës drejt Zvicrës bashkë me trajnerin Bujar Turjaka, kryetarin e Federatës së Skitarisë, Milaim Kelmendi, presidentin e KOK-ut, Besim Hasani. Drin Kokaj dhe Era Shala do të garojnë në disiplinat e skijimit alpin: slalom dhe slalom të madh. Ata kanë shkuar në Zvicër me shpresën që ta përfaqësojnë denjësisht vendin tonë. Për Kosovën kjo do të jetë hera e parë që merr pjesë në Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj, ndërsa i është rezervuar një pritje e ngrohtë në Fshatin Olimpik.

Murphy: Xhaka do të ishte i jashtëzakonshëm në Liverpool

Ish-mesfushori i Liverpoolit, Danny Murphy, ka thënë se Granit Xhaka do të ishte një lojtar i jashtëzakonshëm po të ishte pjesë e Liverpoolit. Legjenda e Liverpoolit shprehet se shpeshherë tek Arsenali, Xhaka është si "pasagjer" në aspektin defenziv për shkak të problemeve që ka aktualisht skuadra londineze, por thekson se përkrah Fabinhos e Hendersonit mesfushori shqiptar do të ishte i jashtëzakonshëm. "Nëse Xhaka do të ishte pjesë e Liverpoolit me Hendersonin dhe Fabinhonin, ai do të dukej një lojtar i jashtëzakonshëm sepse teknikisht është shumë i mirë, ka pasime të mira, goditje fantastike dhe ka aftësi fantastike që me të majtën e tij ta hapë lojën. Por, kur luani në një ekip që ka vështirësi, ai është si pasagjer në mbrojtje dhe ka pengesa", ka thënë Murphy për Talk Sport.

Neymari: Dua të fitoj gjithçka me PSG-në dhe Brazilin

PARIS, 8 JANAR - Neymari është totalisht i fokusuar për të bërë mirë në fushën e lojës. Gjatë një aktiviteti të organizuar nga sponsorët e tij, braziliani ka rrëfyer objektivat për vitin 2020. "Dëshiroj të fitoj gjithçka me PSG-në dhe me përfaqë-

suesen e Brazilit. Dua ta fitoj Ligën e Kampionëve dhe Kupën e Amerikës. PSG-ja i ka të gjitha mundësitë për të fituar. Do ta provojmë", ka thënë Neymari, i cili zbuloi se do të kishte pasur dëshirë të luante me Zidanen apo Romarion,

kurse theksoi se do t'i pëlqente ta shkëmbente fanelën me Zlatan Ibrahimoviçin. Në intervistën e tij, sulmuesi brazilian nuk preferoi të kthehet pas në kohë pasi 2019-ta ka qenë një vit shumë i vështirë për të në aspektin

personal, një vit i mbushur me dëmtime. Në mënyrë të çuditshme, Neymari në asnjë çast nuk shprehu më pëlqimin për një rikthim të mundshëm te Barcelona duke përsëritur dëshirën për ta vijuar bashkëpunimin me PSG-në.



Italia, kundërshtarja e parë e Kosovës

PRISHTINË, 8 JANAR - Italia është kundërshtarja e parë e Kosovës në fazën e parë të kualifikimeve për Kampionatin Botëror të vitit 2021. Italia e Kosova përballen të premten nga ora 20:00 në palestrën "Pala Tedeschi" në Benevento të Italisë. Në grupin e tretë bëjnë pjesë edhe Rumania e Gjeorgjia që takohen të premten nga ora 18:00. Italia në përbërje ka vëllezërit nga Kosova, Ardian e Endrit Iballi. Njëjtë si Kosova, Italia e synon vendin e parë në grup për të kaluar tutje, ndërsa llogarit shumë në përkrahjen e shikuesve. Italia vetëm një herë është paraqitur në Botëror, në vitin 1997. Ishte renditur e 18-ta. Po ashtu, në Evropian ka garuar vetëm një herë në vitin 1998 dhe u rendit në vend të 11-të. Ka suksese në Lojërat Mesdhetare. Në kualifikimet për Botërorin e



kaluar ishte ndalur në raundin e parë kualifikues. Kishte përfunduar e dyta në grup, pas Rumanisë, duke mos avancuar tutje. Edhe në vitin 2018 e kishte organizuar turneun kualifikues në Bolzano. "Synojmë të kualifikohemi. E dimë që është

vështirë, por luajmë në Itali dhe kjo shpresojmë që do të na japë më shumë entuziazëm dhe forcë", ka thënë Ardian Iballi, një prej lojtarëve kryesorë të Italisë. Italia ka synimet e saj, por edhe ne i kemi synimet tona, ta hapin garën kualifikuese me fitore.

LeBron 'shëtit' ndaj New York-it, Detroiti mezi e mposhti Clevelandin

NJU YORK, 8 JANAR - New York Knicks rezultoi "kafshatë" e lehtë për Los Angeles Lakersin, që përmbushi pritshmëritë e publikut në "Staples Center", me një fitore të thellë 117-87. Plot 30 pikë diferencë, çka tregon epërsinë e padiskutueshme të kalifornianëve, të udhëhequr nga LeBron Jamesi, më i miri mbi parket me 31 pikë. Në fakt, mbrëmja e basketbollit amerikan nisi me përballjen mes Cleveland Cavaliersit dhe Detroit Pistonsit, me këtë të fundit që fitoi me vetëm 2 pikë diferencë, 113-115. Vendimtare 24 pikët e Derrick



Rose si dhe 23 pikët dhe 20 "reboundet" e Andre Drummondit, i cili mund të largohet së shpejti nga skuadra e Michiganit. Tjetër humbje në shtëpi për kampionët në fuqi të Toronto Raptorsit me rezultatin e ngushtë 99-101 ndaj Portland Trail Blazersit. Një sukses që i faturohet Carmelo Anthonyt, autor i 28 pikëve dhe i 7 "rikuperimeve". Për Blazersin shtoi edhe 20 pikë të tjera dhe 9 asistime Lillardit, ndërsa përpjekja e Kyle Lowry, që e mbylli takimin me 24 pikë, nuk

mjaftoi për ta shmangur humbjen e Raptorsit, raporton "Supersport". U desh koha shtesë për ta përcaktuar fituesin në duelin mes Brooklyn Netsit dhe Oklahoma City Thunderit. Skuadra mike ruajti qetësinë pas përfundimit të kohës së rregullt dhe falë 28 pikëve të Chris Paulit triumfoi me rezultatin 103-111. Vazhdojnë të mahnitin talentet e Memphis Grizzliesit që, falë suksesit 119-112 përballë Minnesota Timberwolves, i afrohen vendit të tetë në Konferencën e Perëndimit. Spikati "rekruti" Ja Morant, autor i 25 pikëve dhe 7 asistimeve, sikurse Dillon Brooks (28 pikë) dhe Jaren Jackson Jr. (21 pikë). Forma e mirë e Devin Bookerit, i cili realizoi 34 pikë përballë Sacramento Kingsit, rezultoi e pamjaftueshme për Phoenix Suns, që u dorëzua në fund me rezultatin 103-114.

SHKURT

Latifi më 8 shkurt përballlet me Lewisin

Është konfirmuar meçi i radhës i Ilir Latifit në serinë e njohur të arteve marciale të përziera UFC. Ai do të përballlet me Derrick Lewisin më 8 shkurt në Houston. Lewis deri tani ka 22 fitore e shtatë humbje, ndërsa Latifi në karrierën e tij ka 14 fitore e shtatë humbje.

Vajushi transferohet në ligën e dytë të Rumanisë

Armando Vajushi ka gjetur më në fund një ekip të ri, pas shumë muajsh pushim. Dëshira e këtij futbollisti ka qenë për t'iu bashkuar Avelinos, por ky i fundit nuk e ka marrë në ekip. Futbollisti shkodran është marrë nga ana e Petrolul Ploiesti, që merr pjesë në ligën e dytë të kampionatit në Rumani. Njoftimi ka ardhur nga vetë drejtuesit e klubit se kanë marrë edhe Armando Vajushin si përforsim për merkaton e dimrit.

Mbappen, gati ta vazhdojë kontratën me PSG-në

Kylian Mbappe është i gatshëm t'u japë fund spekulimeve rreth të ardhmes së tij. E përditshmja sportive franceze "L'Equipe" raporton se Paris Saint-Germain ka filluar kontaktet për vazhdimin e kontratës me yllin e saj. Drejtori i klubit, Leonardo, është në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e Mbappes në mënyrë që të konfirmojë të ardhmen e tij në "Parc des Princes". Mbappe së fundmi ishte kërkuar nga Real Madridi.

Kahn: Nubel e shikoj si numrin një absolut në harkun e pak viteve

Oliver Kahn është anëtar i ri i bordit drejtues të Bayern Munchenit. Ish-portieri i kombëtares gjermane foli edhe për blerjen e Alexander Nubel nga Schalke 04. "Blerja e Nubelit ka qenë një vendim shumë i zgjuar nga ana jonë. Flasin për një zgjedhje strategjike për të ardhmen e klubit. Ai duhet të vazhdojë të rritet, duke shfrytëzuar edhe mundësinë për të mësuar edhe nga një portier i kalibrit të Neuerit. Personalisht e shikoj si numrin një absolut në harkun e pak viteve", ka deklaruar Kahn.

Verstappen refuzon Ferrarin dhe Mercedesin

Max Verstappen ka rinovuar kontratën me makinën Red Bull deri në vitin 2023. Piloti holandez ka hedhur kështu poshtë zërat e një transferimi të mundshëm te Mercedes apo Ferrari, pasi kontrata i skadonte në fund të këtij viti. "Nuk keni parë ende asgjë. Më e mira është ende përpara", ka deklaruar 22-vjeçari Max Verstappen. "Jam i lumtur dhe krenar që ndodhem te Red Bull. E nisëm këtë rrugëtim së bashku dhe do të vazhdojmë së bashku. Dua të fitoj me këtë makinë. Objektivi im është titulli kampion", ka shtuar Verstappen.

Milani nxjerr në shitje Suson

AC Milan është duke kaluar në një periudhë jo të mirë dhe drejtuesit e klubit menjëherë kanë nisur të mendojnë për ndryshimet gjatë afatit kalimtar të janarit. Ata përfundimisht kanë vendosur që ta vendosin në shitje sulmuesin spanjoll Suso në këtë afat kalimtar. Spanjollit nuk është duke kaluar në formën e tij më të mirë, madje raportohet se aventura e tij në "San Siro" është duke shkuar drejt fundit. Suso u transferua te Milani në vitin 2015 nga Liverpooli si lojtar i lirë dhe që nga ajo kohë 26-vjeçari ka zhvilluar gjithsej 152 ndeshje në të gjitha garat ku ka arritur të shënojë 24 gola.

REZULTATET

Detroit Pistons - Cleveland Cavaliers	115-113
Portland Trail Blazers - Toronto Raptors	101-99
Oklahoma City Thunder - Brooklyn Nets	111-103
Minnesota Timberwolves - Memphis Grizzlies	112-119
Sacramento Kings - Phoenix Suns	114-103
New York Knicks - Los Angeles Lakers	87-117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)-The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerzitetski Klinički Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 e 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 6 paragrafi 1.1 dhe nenit 13 pika 1 dhe 3 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Qendra Klinike Universitar e Kosovës (SHSKUK), nenit 12, paragrafi 6.17 si dhe nenit 13 pika 1 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; Nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016, dhe Kërkesa nr. 4, datë 03.01.2020, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK shpallë:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Titulli i vendit të punës: Dy (2) Mjekë Specialistë të Kardiokirurgjisë

Koeficienti i pagës: (8.40)
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Drejtorit dhe Shefit të Repartit në Klinikën e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive të QKUK-së.
Nr. i Referencës: QKUK-01/2020-01/2

Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasiar bazuar në nivelin profesional që ka.

Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist – Kardiokirurgj:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkon lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësitimit profesional dhe kolektiv në repart (njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj.
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punon në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

Shkollimi i kërkuar: Të ketë arsimim universitar nga lëmia e Kardiokirurgjisë me edukim plotësues profesional.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:

- ✓ Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- ✓ Licenca e Specialistit të Kardiokirurgjisë (e përhershme ose e përkohshme nga Oda e Mjekëve të Kosovës, në këto raste edhe kopja e diplomës origjinale të specializimit);
- ✓ Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnim të veçantë, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- ✓ Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- ✓ Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme;
- ✓ Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm, dhe
- ✓ Certifikata e lindjes, fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat (të kërkuar) si dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar nga kjo fushë.
Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e shpalljes në njërin nga gazetatat ditore.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit të QKUK-së.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)-The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerzitetski Klinički Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Kadrovska Sluzba

Prema članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 6. tačka 1.1 i član 13 tačka 1 i 3. Statuta Bolničke Sluzbe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), člana 12 tačka 6.17, kao i član 13 tačka 1. Statuta Kliničkog Univerzitetski Centr Kosova, kao i član 62, stav 6, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo; Član 5, Uredbe o Radnim Odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; i Zahtev br. 4, dana 03.01.2020, Generalni Direktor UBKSK, raspisuje:

KONKURS

Institucije: Univerzitetski Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova. (UBKSK)
Univerzitetski Klinički Centar Kosova (UKCK)

Radno mesto: Dva (2) Lekari specijalista za kardiokirurgiju
Koeficijent zarade: (8.40)
Radna Vreme: Puno radno vreme (40 sati nedeljno).
Ugovor: P
Izveštaj: Direktor i Šefu Odeljenja na Klinici za Kardiokirurgiju i Invazivnu Kardiologiju UKCK.
Referentni br. UKCK - 01/2020-01/2

I. Osnovna svrha posla – za specialista kardiokirurgije:

Pružanje zdravstvenih usluga u pogledu kvaliteta i kvantiteta zasnovane na profesionalnom nivou koj je ima.

Odgovornost – Kardiokirurgja:

- Zajedno sa šefom odeljenja i ostalih nadzornog osoblja upravlja ljudskim resursima, opreme, objekata inventar za nivo na kome pripada.
- Obezbedi visok standard nege pacijenata.
- Ljubaznost, briga i poštovanje za pacijente i osoblje radi.
- Ljubaznost i saradnja sa drugim osoblje koje radi profesionalno.
- Prijem, ispitivanje i lečenje pacijenta u pitanju.
- Redovno identifikaciju putem medicinske dokumentacije (istorija bolesti, otpusni list, protokol, itd) pacijenta.
- Izvršiti redovne posete bolničko lečenje u zdravstvenoj ustanovi.
- Napravljeni zahteva za dodatnim konsultativne posete,
- Vrši nadzor primene dnevnih radnih zadataka radne osoblja.
- Daje stručna mišljenja za rad koji obavljaju.
- Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.
- Vrši konkretne zadatke kada je to potrebno u vezi sa profesijom stručnjaka koji je blisko.
- Odgovoran je za izradu nastavnog plana i programa njegovog rada individualnih i kolektivnih na radnom mestu,
- Angažuje osoblje koje radi u realizaciji svakodnevnih radnih zadataka,
- Obezbediti i razviti programe stručnog osposobljavanja,
- Vrši redovnu kontrolu (inspekciju objekata, opreme i inventara na radnom mestu).
- Proverite da li je okruženje je čist i bezbedan za sve,
- Upravlja potrošnog materijala i druge opreme,
- Obezbeduje efikasnog sistema komunikacije za sve unutar institucije,
- Analizira i realizuje profesionalne protokole pacijenta,
- Učestvovanje u stručnim naučnim istraživanjima,
- Preduzima mere za povećanje menadžerskih kvalitete i jedinicu kolektivne na odeljenje (Jedinice)
- Izvršiti dodatne zadatke na osnovu njihove profesionalne kvalifikacije i upravljanje, itd
- Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom smislu zasni na profesionalnom nivou tamo,
- Davanje stručne savjete u tumačenju o lečenju pacijenata i postavljanje dan tretmana,
- Određi redosled i plan kliničko-laboratorijskih egzaminacija,
- Da bi se rad u klinici ambulantno i ispituje njihovu readmisiju.

Obrazovanje je potrebno: Da ima univerzitetsku diplomu iz oblasti kardiokirurgije sa dodatnim stručnog obrazovanja.

Sposobnost / iskustvo i druge osobine potrebno:

- * Diploma Medicinskog fakulteta;
- * Licenca specijalista kardiokirurgija (stalno ili privremeno od strane Lekarske komore Kosova, u ovom slučaju kopija originalne diplome specijalizacije);
- * Prioritet će biti dat kandidatima koji imaju posebnu obuku i dobro poznavanje funkcionisanja zdravstvenog sistema na Kosovu;
- * Da ima dokazali veštine i efikasne komunikacije u pismeno i usmeno, imaju znanje službenih jezika u upotrebi;
- * Poznavanje rada sa kompjuterom je od suštinskog značaja i znanje engleskog jezika je povoljno;
- * Licna karta fotokopija ili privremeni boravak i
- * Izvod matične knjige rođenih, fotokopija.

Uslovi učešća u zapošljavanju: pravo da se prijave svi su državljani Republike Kosova odrasli koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje (traženi sa ovom konkursom) i imaju adekvatnu stručnu sposobnost za obavljanje zadataka.

Zbornik radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: **15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.**

Podnošenje prijave: Prijave se uzimaju i dostavljaju - Sektor kadrovski UKCK.

U prijavi treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Sva dokumenta i dokaz profesionalno da se pridruži aplikaciju.

Podnete aplikacije po isteku roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrje Hidroekonomike "Iber lepec" Sh.A. Prishtine,
Publikon këtë:

NJOFTIM

1. Anulohet konkursi i shpallur me datën 16.11.2019, ne gazetën "Epoka e Re" me te cilin është kërkuar: Zyrtar/e ligjorë/e (1), Zyrtar për asete material dhe inventarë ne Nj.P "Shkabaj"(1), Zyrtar për asete material dhe inventarë ne Nj.P "Vushtrri"(1), Asistent/e ne Njësinë Zbatuese te Projektit te Bankës Botërore "Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit" (1), Perkthyes/e në gjuhën shqipe, angleze, serbe dhe anasjelltas (1), Teknik i Ndërtimtarisë (1), Ndihmes Pompist ne Stacionin Pompik ne Çagllavicë (1), Pastrues/e (Punetore i/e higjienës) në NJ.P "Vushtrri" (1), Evidentues-Administratore ne Nj.P, "Komoran" (1).
2. I falënderojmë te gjithë pjesëmarrësit në konkurs.

Sot përkujtohet tetë vjetori i vdekjes së veprimtarit



Avdullah Rustolli

Sot (e enjte) bëhen tetë vjet nga vdekja e veprimtarit dhe ish të burgosurit politik, Avdullah Rustolli i cili ka qenë i dënuar me 12 vjet burgim për aktivitetet e tij patriotike, së bashku me veprimtarët të tjerë, në krye me Adem Demaçin.
E kujton me mall Familja Rustolli.
Pusho i qet Dijetar!

KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRISTINA
NPL Pallati i Rinisë sh. a. - OJIP Pallati i Rinisë d. d.
Nr. 1/7 dt. 08.01.2020
PRISHTINE - PRISTINA

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, vendimin nr. 22/2019 datë 04.11.2019 të Bordit të Drejtorëve dhe vendimit të Menaxhmentit të datës 04.12.2019, NPL PALLATI I RINISË SH.A. - Prishtinë, me datë 09.01.2020, SHPALLJE:

KONKURSI PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: electricist i tensionit të lartë (2 pozita);

II. Numri i referencës: NPL-D.T. 04/12/19/1;

III. Detyrat dhe përgjegjësitë:
- Bënë evidentimin e prishjeve të instalimeve dhe elementeve të tyre nëpër lokale të Pallatit të Rinisë si dhe eliminimin e tyre brenda afatit sa më të shkurtër.
- Përcjellin dhe bëjnë përgatitjen për mirëvajtjen e manifestimeve - programeve dhe ndeshjeve sportive në Pallatin e Rinisë me sa vijon:
- Plotësimin e ndërrimit sipas kërkesave të programit, Plotësimin e kyçeve të përkohshme elektrike sipas kërkesave të programit,
- Lëshimin në punë të burimit rezervë të energjisë elektrike - gjeneratorit në rast të mungesës së tensionit nga rrjeti. Bënë kontrollimin e gjeneratorit në punë boshe, Kujtesën dhe rregullojnë ngarkesën në pjesë të gjeneratorit gjatë funksionimit të tij,
- Kryen punët në ndërrimin e pjesëve të stabilimenteve shpërndarës sipë janë:
- Ndërrimi i ndarësve sigurues dhe zëvendësimi me të njëjtin në gjendje të rregullt ose me "AS", Ndërrimi i njehsorëve, Ndërrimi i përgjuesve të dëmtuar dhe elementeve të tjera,
- Gjatë ndërrimit të natës përcjellin gjendjen në Pallatin e Rinisë, me sa vijon:
- Ndërrimin e furnizimit me energji nëse ndonjë lokal ka harruar ndërrimin e plotë apo ndonjë nxehëse që janë të rrezikshme për objektin, Bënë instalime shtesë të përkohshme apo edhe të përhershme që kërkohen nga ana e Pallatit të Rinisë,
- Në bazë të urdhërave nga ana e Pallatit të Rinisë, kryejnë punët jashtë orarit që i përkasin remonteve me instalime elektrike siç janë:
- Ridimensionimi i furnizimeve me energji elektrike - kablllove, Ndërrimi i tërësive të kablllove në Qendër etj.
- Bënë kyçje të aparateve elektrike të reja apo ndërrimin e tyre siç janë:
- Bojlerët e ndryshëm, Fshesat elektrike, Nxehëset elektrike etj,
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhërimit të eporëve kompetent.
- Për punën e vet i përgjigjet kryepunëtorit, udhëheqësit të njësisë - përgjegjësit për energjetikë si dhe Drejtorit Teknik.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit
- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Letër motivuese;
- Dëshmi për shkollimin e noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo vepra të tjera.
- Certifikata e mjekut,
- Certifikata se keni zotësi të veprimtarit,
- Kopja e letërnyfjimit;
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës
- Diploma e noterizuar e kualifikimit të mesëm shkollor ose i lartë - drejtimi electricist i tensionit të lartë.
- Përvoja e punës në profesionin e njëjtë,
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

VI. Kohëzgjatja e emërimit:
- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbylljes së konkursit:
- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike dhe atë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:
- Aplikacionet për punësim merren dhe dorëzohen në arshivën e Departamentit të Administrimit Qendror.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRISTINA
NPL PALLATI I RINISË SH.A.
Ilir Dugolli
U.d. Kryeshef Ekzekutiv

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ilir Bytyqi, shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik, drejtimi Banka dhe Financa, si dhe diplomën e studimeve të Magjistraturës, drejtimi Menaxhment dhe Informatikë.

► EDI-SHA, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810737364.

► "ASL" SH.P.K. shpall të humbur dokumentet e biznesit me nr. Fis. 600784137, nr biz. 70832739 dhe me nr. Unik 810815417.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188


► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralla Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.

KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!


BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqët tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobalarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN

Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përftuar nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiency të energjisë.